Së dyti, ai supozon që popullsia e Kosovës është duke u përpjekur jo vetëm për sisteme më të mira arsimore dhe të punësimit, por për një kohezion më të fuqishëm strukturor duke lidhur autoritetet me komunitetet dhe komunitetet me zhvillimin e vet. Këto tema janë dizajnuar për të inkurajuar bashkëpunimin më të madh të mundshëm ndër-sektorial në tërë kontekstin e Kosovës. Në fund të fundit, qëllimi është që të përshpejtohet gjithëpërfshirja e më të cenueshmeve në shoqërinë e Kosovës.

Në fund, PPZH-ja e UNKT-së pranon kufizimet e qarta të fushëveprimit të OKB-së në adresimin e sfidave lidhur me zhvillimin dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Me një kontribut prej afërsisht 30 milion dollarë amerikan për programe të përbashkëta gjatë pesë viteve të ardhshme, UNKT-ja nuk e paraqet veten si donatorë madhorë në kontekstin e Kosovës. Ky dokument modest është dizajnuar për të bashkërenduar resurset e konsiderueshme teknike të UNKT-së për të plotësuar partneritetin më të gjerë zhvillimor në Kosovë. Qëllimi i saj është që në këtë moment të rëndësishëm për Kosovën, të forcojë përkushtimin e thellë të OKB-së për popullatën e Kosovës dhe të krijojë prani më të targetuar të UNKT-së për të katalizuar potencialin e konsiderueshëm të vet Kosovës në epokën Post 2015.

Përmbajtja

Deklarata e zotimit

Përmbledhje

Shkurtesat

1. Hyrje
2. Analiza e kontekstit
 - 2.1. Analiza e gjendjes dhe shkaktarëve
 - 2.1.1 Rritja ekonomike dhe gjithëpërfshirja sociale
 - 2.1.2 Tregu i punës
 - 2.1.3 Arsimi
 - 2.1.4 Shëndeti
 - 2.1.5 Mjedisi
 - 2.1.6 Sundimi i ligjit
 - 2.1.7 Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut për gratë
 - 2.1.8 Migrimi
 - 2.2 Prioritetet ekzistuese politike dhe zhvillimore
 - 2.3 Vlera e shtuar e Kombeve të Bashkuara në Kosovë
3. PPZH e UNKT-së
 - 3.1 Rezultatet e pritura nga PPZH-ja
4. Implementimi i PPZH-së
 - 4.1 Strukturat implementuese dhe mbikëqyrëse të PPZH-së
 - 4.2 Monitorimi dhe vlerësimi
 - 4.3 Plani i financimit
 - 4.4 Advokimi për komunikimin e rezultateve të PPZH-së

Referencat

Shtojca 1: Matrica e rezultateve të PPZH-së së KB-së 2016-2020

Shtojca 2: Strategjitë sektoriale dhe planet e veprimit me rëndësi për PPZH-në

Shkurtesat

BEEPS	Anketa e performancës së mjedisit biznesor dhe ndërmarrës
BOS	Strategjia për Operimet Biznesore
PZHP	Plani i përbashkët Zhvillimor
NPK	Norma e prevalencës së kontracepsionit
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
ZRF	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
BPV	Bruto prodhimi vendor
DhBGj	Dhuna e bazuar në gjini
IZhNj	Indeksi i zhvillimit njerëzor
RZhNj	Raporti i zhvillimit njerëzor
UeA	Udhëheqësit e agjencisë
PZhBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KEPA	Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
LGBT	Lezbike, homoseksuale, biseksual dhe transeksual
MeV	Monitorim e vlerësim
OZhM	Objektivat zhvillimore të mileniumit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MICS	Anketimi i grupimeve të treguesve të shumëfishtë
MNCRH	Maternal, Neonatal, Fëmija dhe Shëndeti Reproductiv
KAMSh	Korniza afat-mesme e shpenzimeve
NCD	Sëmundjet jo të komunikueshme
SKZh	Strategjia kombëtare për zhvillim

OHCHR	Zyra e Komisionerit të lartë për të Drejtat e Njeriut
EMO	Ekipi i menaxhimit të operimeve
ZKM	Zyra e Kryeministrit
QCPR	Shqyrtimi i katërvjetshëm gjithëpërfshirës i politikave
MBR	Menaxhimi i bazuar në rezultate
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OZhQ	Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm
ShSR	Shëndeti seksual dhe reprodaktiv
TQNj	Trafikimi me qenie njerëzore
UNDAF	Korniza e Kombeve të Bashkuara për Asistencë Zhvillimore
UNDG	Grupi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNDC	Koordinatori i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedis
UNFPA	Fondi Popullor i Kombeve të Bashkuara
UNHabitat	Programi për Vendbanimet Njerëzore i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNMIK	Misioni i Administrimit të Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
UNSF	Korniza Strategjike e Kombeve të Bashkuara
UNV	Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara
UN Women	Subjekti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
BB	Banka Botërore
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë

PPZH 2016-2020 e UNKT-së shërben si kornizë strategjike për përpjekjet e përbashkëta të UNKT-së të koordinuara sipas rrethanave të favorshme të Koordinatorit për Zhvillim të KB-së (KZHKB). PPZH-ja nuk pasqyron tërësinë e programeve dhe aktiviteteve të implementuara nga sistemi i KB-së në Kosovë. Ai vetëm pasqyron fushat për bashkëpunim strategjik të UNKT-së për arritjen e objektivave të përbashkëta, parimisht përmes programeve të përbashkëta dhe advokimit të përbashkët. Në këtë mënyrë, PPZH-ja duhet të shihet si plotësim i iniciativave të agjencive individuale.

Dokumenti ka për qëllim që të jetë instrument praktik dhe i favorshëm për lexuesin që përshkruan se si propozon UNKT-ja që të kontribuohet në mënyrë të përbashkët në arritjen e rezultateve zhvillimore dhe sfidave të të drejtave të njeriut në Kosovë në disa fusha prioritare strategjike. Ai konsiderohet si vegël për të mbështetur UNKT-në në sigurimin e Menaxhimit të Bazuar në Rezultate (MBR) duke matur dhe duke demonstruar shkallën e arritjes së objektivave të saj, efikasitetin dhe rëndësinë e aktiviteteve të saj dhe nivelin e kontributit në rezultatet e zhvillimit në Kosovë. Për më tepër, PPZH-ja konsiderohet një vegël për të përmirësuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet agjencive, si dhe për të fuqizuar partneritetin ndërmjet autoriteteve dhe shoqërisë civile në Kosovë dhe për të kontribuar në sistem më të fuqishëm Koordinimi të KB-së.

PPZH-ja mbështetet nga korniza e Shqyrtimit të Katërvjetshëm Gjithëpërfshirës të Politikave (QCPR); rezoluta e pikës së referimit (67/226) e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së në dhjetor të vitit 2012 për vlerësimin e efikasitetit, koherencës dhe ndikimit të aktiviteteve operative të KB-së për zhvillim. Disa subjekte të KB-së tashmë e kanë harmonizuar planet e tyre të reja strategjike me QCPR-në edhe në aspektin kohor edhe në atë të përmbajtjes. Përderisa intervali kohor i QCPR-së mbulon periudhën 2012-2016, PPZH-ja do të mbështetet në rekomandimet që dalin nga kjo rezolutë dhe raportet tjera për një harmonizim më të efektshëm me objektivat zhvillimore të dakorduara ndërkombëtarisht dhe

me nevojat e prioritetet e identifikuar në nivelin lokal. PPZH-ja më tutje udhëhiqet nga qasja "të vepruarit si një" e cila synon fuqizimin e performancës së sistemit të KB-së në nivel lokal. Të motivuar nga Procedurat Standarde të Operimit të "të vepruarit si një", UNKT-ja ka aprovuar këtë qasje në fushat që janë më relevantet për kontekstin e Kosovës. Më specifikisht, UNKT-ja është e përkushtuar që të rrisë performancën e saj duke krijuar vlera shtesë përmes programit të përbashkët, duke u bërë më efikas përmes shërbimeve të përbashkëta të KB-së dhe duke avancuar ndikimin përmes advokimit të përbashkët. PPZH-ja për më tepër ndodhet në thelbin e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale të të Drejtave të Njeriut, si dhe të Objektivave për Zhvillim të Mileniumit (OZHM) dhe Agjendën Zhvillimore Post 2015 në evoluim.

PPZH 2016-2020 i UNKT-së është zhvilluar në konsultim të ngushtë me autoritetet kosovare në nivel qendror, me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) vendore e ndërkombëtare në kontekstin e debateve zhvillimore të Post 2015, dhe me komunitetin ndërkombëtar të përbërë nga organizata ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale. Synimi kryesor ka qenë siguri i harmonizimit me nevojat vendore dhe agjendat zhvillimore. Procesi i konsultimeve i mbajtur gjatë viteve 2014 dhe 2015 gjithashtu ka shërbyer si mënyrë për të promovuar pronësinë vendore mbi proceset, si dhe për të fuqizuar partneritetin ndërmjet këtyre palëve kyçe të interesit dhe UNKT-së si grup. Tërthorazi, ky proces ka shërbyer në kontributin për aplikimin e Deklaratës së Parisit dhe parimeve të Partneritetit të Busanit. Paralelisht me procesin e konsultimeve, UNKT-ja ka mbledhur të dhëna nëpër sektorë me qëllim të analizës së gjendjes aktuale të rezultateve kryesore të zhvillimit dhe të shtytësve dhe kufizuesve të të drejtave të njeriut në Kosovë. Sektorët që kanë ndikimin më të madh në zhvillimin e Kosovës janë paraqitur në analizën e kontekstit në këtë dokument.

Në të njëjtën kohë, UNMIK-u dhe UNKT-ja janë duke përditësuar Kornizën Strategjike të KB-së (UNSF) për periudhën 2015-2017 për të artikuluar objektivat dhe qasjet e përbashkëta strateg-

jike në konsolidimin e paqes për të tërë sistemin e KB-së në Kosovë. Korniza gjithashtu përshkruan përgjegjësitë e aktorëve të KB-së dhe mekanizmat koordinues në këtë proces. Për më tepër, UNSF-ja qartëson pozicionimin dhe rolin strategjik të KB-së përballë akterëve vendorë e ndërkombëtarë në bazë të përparësive krahasuese të KB-së. Të dyja përpjekjet do të jenë të ndara, por të sinkronizuara dhe që në mënyrë të ndërsjellë forcojnë njëra tjetrën.

Struktura dhe përmbajtja e PPZH 2016-2020 e UNKT-së mbështetet në udhëzimet e përgjithshme të ofruara nga Grupi Zhvillimor i KB-së (UNDG) për cilindo dokument UNDAF. Ajo gjithashtu mbështetet në shembujt e mirë të UNDAF-së të ndara nga Grupi Përkrahës Homolog për Evropë dhe Azi Qendrore dhe evolimi logjik nga PPZH-ja 2011-2015 aktuale e UNKT-së. Kapitulli 2 analizon gjendjen aktuale të zhvillimit përmes qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, aty shqyrtohet mje-

disi i cili do të mund të mundësonte përmbushjen e të drejtave të njeriut për njerëzit në Kosovë, qasjen në shërbime dhe mundësinë për të gëzuar të drejtat e tyre. Aty gjithashtu analizohet kapaciteti i autoriteteve për të përmbushur obligimet e tyre. Vazhdohet me një analizë të shkurtër të prioriteteve ekzistuese politike dhe zhvillimore në Kosovë. Më tej vazhdohet me përshkrimin e vlerës së shtuar dhe përparësive krahasuese të sistemit të KB-së në Kosovë. Analiza e elementeve ofron bazën mbi të cilën UNKT-ja ka përzgjedhur tri fushat prioritare për përpjekjet e përbashkëta për periudhën e ardhshme 2016-2020. Në Kapitullin 3 është bërë përshkrim narrativ për secilën fushë prioritare dhe për ndryshimet e pritura të cilat UNKT-ja synon t'i arrijë përmes përpjekjeve të përbashkëta. Në Kapitullin e fundit janë paraqitur strukturat e propozuara për implementimin e PPZH 2016-2020 të UNKT-së.

2. Analiza e kontekstit

PPZH 2016-2020 e UNKT-së bazohet në vlerësimin e asaj se ku qëndron Kosova në raport me standardet e përcaktuara në MDG dhe në objektivat tjera zhvillimore ndërkombëtare. Ai gjithashtu bazohet në vlerësimin se ku qëndron Kosova në raport me standardet e përcaktuara në instrumentet relevante ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut. Qëllimi është që të përcaktohet se ku ekzistojnë barrierat në zhvillim, të specifikohen kufizimet që njerëzit në Kosovë i hasin në qasjen në shërbime dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, në mënyrë që të shtyhen autoritetet që të përmbushin obligimet e tyre.

1.1. Analiza e gjendjes dhe shkaktarëve

Angazhimi i KB-së në Kosovë mbetet sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së (1999) dhe rrjedhimisht qasja e Kosovës në platformat globale zhvillimore të KB-së, fondet e mirëbesimit dhe konventat ndërkombëtare për raportim lidhur me zhvillimet e arritura dhe standardet

e të drejtave të njeriut mbetet e kufizuar. Megjithatë, autoritetet në Kosovë kanë përfshirë aspekte thelbësore të disa instrumenteve të drejtave të njeriut në aktet e tyre normative. KB-ja e ka mbështetur Kosovën në përgatitjen për përgjegjësitë e mundshme të ardhme të raportimit për konventat e KB-së për të drejtat e njeriut, duke përfshirë mënyrën përmes ushtrimeve të raportimit "sikur" në pajtueshmëri me kërkesat globale. KB-ja gjithashtu e ka përkrahur Kosovën për të kontribuar në disa rrjedha zhvillimesh që janë të hapura për kontribute nga Kosova pavarësisht nga statusi politik; një nga to është raporti i konsultimit i vlerësuar lartë dialogu Post 2015.

Gjatë diskutimeve për Objektivat Zhvillimore të Mijevjeçarit (OZHM-të) në vitin 2000 nuk ishin marrë shqetësimet e njerëzve në Kosovë për shkak të gjendjes së pas krizës, por 15 vite më vonë, ato tani janë shprehur përmes raportit global "Një milion zërave: debati Post 2015." Rezultatet vijnë nga një proces i hollësishëm konsultimi të paraqitura

4 Korniza për Asistencë në Zhvillim e KB-së (UNDAF)

5 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokolet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW); Konventa për të Drejtat e Fëmijës; dhe Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese.

6 Debati i Kosovës Post 2015: Mekanizmi i Llogaridhënies në Arsim dhe Punësim; Rasti i Kosovës, tetor 2014, UNKT.

7 Raporti për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë (RZHNJ) 2012, UNDP.

në raport që futet thellë në arsyet për norma të vazhdueshme të varfërisë dhe pabarazitë në qasjen në mundësitë për punësim dhe arsim të cilësisë së lartë; prioritetet që populli i Kosovës i ka shprehur si më të rëndësishmet për të ardhmen. Raporti gjithashtu ka ofruar një analizë të detajuar lidhur me atë se si të rriten llogaridhënia në Kosovë; një element i identifikuar si një prej mangësive aktuale kryesore të autoriteteve. Rezultatet nga dialogu Post 2015 janë përdorur nëpër të gjithë dokumentin e PPZH-së si të dhëna hyrëse në analizën e shkaktarëve dhe në përcaktimin e prioritetëve në fushat e punësimit e arsimit dhe si udhëzues në përcaktimin e strategjive kyçe që duhen përdorur për të arritur rezultatet e pritura.

Një pikë tjetër e rëndësishme referimi për PPZH-në janë Raportet e Zhvillimit Njerëzor (RZHNJ) dhe Indeksi përkatës i Zhvillimit Njerëzor (IZHNJ). Bazuar në të dhënat nga RZHNJ-ja në vitin 2012, IZHNJ-ja në Kosovë kishte arritur në 0.714, duke pozicionuar Kosovën në grupin e anëtarëve me renditje të lartë me IZHNJ. Sidoqoftë, në krahasim me Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Evropian (BE), Kosova ende mbetet në vendin më të ulët. Për të ngritur këtë pozitë ekzistojnë shumë sfida që duhen përballur. MDG-të janë caqet në aspektin kohor të mbarë botës për të adresuar ato që në vitin 2000 ishin vendosur të ishin pengesat kyçe drejt reduktimit të varfërisë dhe zhvillimit njerëzor. Ato kanë ofruar kornizë për agjentët zhvillimorë lidhur me atë se ku të fokusojnë përpjekjet në mënyrë gjithëpërfshirëse deri në vitin 2015, kur do të fillojë Agjenda Zhvillimore Post 2015.

Në terma të përgjithshme ka pasur përparim sa i përket zhvillimit të kapaciteteve të autoriteteve drejt sigurimit të kryerjes së obligimeve të tyre për përmbushjen e të drejtave të njeriut për ata që jetojnë në Kosovë dhe në përmirësimin e disa rezultateve zhvillimore. Autoritetet kosovare në një kohë relativisht të shkurtër kanë arritur nivel të pjekurisë në aspektin e definimit të mandateve, pozitave dhe krijimit të procedurave. Pa e mohuar faktin që ka dallime ndërmjet autoriteteve dhe sektorëve të ndryshëm, reformat ligjore dhe organizative në progres dhe strategjitë sektoriale që aktualisht janë duke u zhvilluar apo implementuar së bashku me përkrahjen nga komuniteti ndërkom-bëtar janë shtytës pozitiv që janë duke krijuar in-

ercionin politik dhe mjedisin pozitiv për përmirësimin e performancës, cilësisë së shërbimeve publike dhe qasjes për grupet më të përjashtuara nga shoqëria. Në mënyrë të posaçme ekziston një vullnet i fuqishëm politik për të siguruar progres në fushat e identifikuar si mangësi në raportet vjetore të progresit të Komisionit Evropian (KE).

Sidoqoftë sfidat mbesin. Gëzimi i plotë nga kosovarët i efektit të plotë të reformave ligjore dhe organizative dhe strategjive sektoriale do të kërkojë monitorim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme për të siguruar implementim sistematik. Ekzistojnë mangësi në kapacitetin organizativ që lidhet me numrin e personelit dhe me ekspertizën e specializimin teknik e menaxherial. Këto fusha përfshijnë vendim-marrjen transparente, menaxhimin, llogaridhënien, sigurimin e cilësisë, njohuritë profesionale dhe politikë-bërjen, buxhetimin dhe planifikimin sipas gjinisë. Fushat tjera që duhet adresuar janë alokimet buxhetore për implementimin e prioritetëve aktuale programore, nevoja për të përmirësuar koordinimin dhe programin ndër-sektorial në nivelet qendrore dhe ato lokale, decentralizimin e përgjegjësive dhe koordinim të agjendave ndër palë të ndryshme të interesit.

Gjatë fazës aktuale të zhvillimit, kosovarët vazhdojnë të ballafaqohen me sfida në ushtrimin e të drejtave dhe në mbajtjen e autoriteteve përgjegjëse, veçanërisht në lidhje me qasjen e barabartë në mundësi për punësim dhe arsim cilësor, qasjen e përmirësuar në shërbime publike dhe mundësinë për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes. Ekzistojnë shumë OSHC vendore që përkrahin ata për të ngritur zërin për këto pretendime, por ka ende pengesa që i nuk lënë ato të bëhen forcë shtytëse me drejta të plota në zhvillimin e Kosovës. OSHC-të do të përfitonin nga ngritja e kapaciteteve në shkathtësitë për advokim dhe lobim dhe me aprovimin e qasjes së fuqishme të menaxhimit të bazuar në rezultate (MBR). Ata për më tepër kufizohen nga qasja e kufizuar në burime financiare para se ata të mund të përshkallëzojnë përkrahjen për strategjitë për sensibilizim lidhur me të drejtat bazike të njeriut dhe reduktimin e stigmës sociale kundrejt disa grupeve të popullatës. Grupet etnike minoritare ballafaqohen me diskriminim dhe barriera gjuhësore dhe gjithashtu edhe ata do të përfitonin nga veprimet më efikase nga OSHC-të

8 Sipas RZHNJ-së globale 2014, grupi i anëtarëve me renditje të lartë të IZHNJ-së ishte pozicionuar në 0.790 (Uruguai)-0.700 (Republika Dominikane).

9 Menjëherë nën Shqipërinë të renditur në 0.716 sipas RZHNJ-së Globale të vitit 2014.

në përkrahjen e pretendimeve të tyre. E njëjta do të ndodhte edhe me gratë, ku shumë nga to afektohen negativisht për shkak të roleve gjinore tradicionale në shoqëri.

2.1.1 Rritja ekonomike dhe gjithëpërfshirja sociale

Rritja ekonomike është instrument i fuqishëm për të reduktuar përjashtimin social dhe për të kontribuar në përmirësimin e standardit të jetesës. Norma e rritjes e kohëve të fundit në Kosovë, e nxitur deri në një shkallë nga rritja e investimeve nga diaspora kosovare, nuk është e mjaftueshme për t'u përkthyer në ndryshime të konsiderueshme në indikatorët e zhvillimit siç janë qasja në punësim, shëndetësia dhe arsimit cilësor apo përmirësimi i shkallës së varfërisë.

Politikat dhe programet e mbrojtjes sociale nuk janë të dizajnuara për të reduktuar aspektet multidimensionale të varfërisë. Skemat aktuale të mbrojtjes sociale në Kosovë mbesin të mangëta kur bëhet fjalë për ofrimin e qasjes së barabartë dhe të duhur për të gjitha grupet e përjashtuara në aspektin social; si në aspektin e mbulueshmërisë ashtu edhe për shumën e beneficioneve.

Regjimi aktual i mbrojtjes sociale përbëhet nga skemat për pensionerë, për veteranë të luftës, ndihmën për aftësi të kufizuara, asistencën sociale si dhe shërbimet sociale të ofruara përmes Qendrave për Punë Sociale në secilën komunë.

Ekonominë në Kosovë ka përfituar nga rritja e lartë mesatare prej 6.3% në vit ndërmjet viteve 2006 dhe 2008. Megjithatë, viteve të fundit nuk ka qenë e mundur të mbahet kjo normë e rritjes. Në periudhën nga viti 2009 deri 2013, ekonomia e Kosovës u rrit me normë mesatare të rritjes më të ulët prej 3.3% në vit. Është e rëndësishme të vihet në pah se gjatë analizës së Bruto Prodhimit Vendor (BPV) për kokë banori, rritja ekonomike ka rënë më tej nga 4.8% në vit në periudhën 2006-2008 në 1.8% në vit në periudhën 2009-2013. (Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Llogaritë Nacionale dhe FMN-ja.

Ekziston ende nevoja për të zhvilluar skema për ndihmë financiare të përgjithshme për fëmijë dhe sigurim shëndetësor ndër shërbime tjera sociale. Benefitet nga asistencë sociale do të përfitonin më tutje nga rregullimet në nivelin bazë dhe për luhatjet në koston e shportës ushqimore.

Ekzistojnë vetëm disa OSHC që kanë qasje në proceset e diskutimeve politike lidhur me skemat e mbrojtjes sociale dhe ato nuk janë gjithmonë në gjendje që realisht të inkorporojnë zërin e grupeve më të përjashtuara sociale. Pasi të jenë arritur dhe miratuar vendimet dhe marrëveshjet, është e domosdoshme që të përkrahen edhe më tutje OSHC-të që të monitorojnë implementimin e vendimeve ligjore dhe politike dhe të vlerësojnë se a janë apo jo duke prekur me të vërtetë grupet më të përjashtuara të shoqërisë.

2.1.2 Tregu i punës

Rritja ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës është në agjendën të autoriteteve në Kosovë dhe

Aspektet multi-dimensionale të varfërisë: Kushtet e banimit dhe qasja në komoditetet bazike siç janë uji i rrjedhshëm janë nën standardet e BE-së. Niveli i varfërisë mbetet i vazhdueshëm dhe i përhapur sipas të dhënave të fundit në dispozicion. Vlerësohet se në vitin 2011 29.7% e popullatës së Kosovës jetonte nën linjën e varfërisë dhe 10.2% e popullatës jetonte nën linjën e varfërisë së skajshme. Niveli i varfërisë i prek njerëzit në Kosovë në mënyrë të pabarabartë. Normat e varfërisë prekin joproporcionalisht fëmijët, me rreth 33% të fëmijëve që jetojnë në varfëri. Më të varfërit jetojnë në zona rurale (65%), pak më shumë gra jetojnë në varfëri krahasuar me burrat (30.3% dhe 29.2% respektivisht) dhe familjet me kryefamiljarë femër kanë normë më të lartë të varfërisë krahasuar me familjet me kryefamiljarë mashkull (39.8% krahasuar me 29%). (Burimi: ASK/BB: Varfëria në Republikën e Kosovës në vitin 2011; mars 2013.) Raportet nga Banka Botërore (BB) dhe Programi për Zhvillim i KB-së (UNDP) vlerësojnë se nivelet e varfërisë dhe cenueshmërisë do të ishin edhe më të larta pa rrjetin e sigurisë të ofruar përmes emigrimit dhe remitencave.)

10 UNKT-ja është dakorduar për të definuar grupin e përjashtuar në aspektin social në harmoni me definicionet që përdoren në Letrën e Bardhë "Sfidat e Gjithëpërfshirjes Sociale në Kosovë" nga tetori 2009. Letra e Bardhë konkludon që ekziston një numër i madh i individëve apo grupeve që vuajnë nga përjashtimi social në Kosovë, siç janë njerëzit e varfër, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Personat e Zhvendosur brenda Vëndit (PZHBV), refugjatët dhe të kthyerit, diaspora, familjet me anëtarë të humbur apo të pagjetur, veteranët dhe invalidët e luftës, të burgosurit politik, personat me çrregullime post-traumatike, gratë viktime të dhunës në familje, gratë e abuzuara gjatë luftës, njerëzit pa kullm mbi kokë, lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët (LGBT), njerëzit e varur nga narkotikët dhe personat që jetojnë me HIV/SIDA.

Rezultatet e tregut të punës kanë mbetur të pandryshuara viteve të fundit. Në vitin 2013, norma e punësimit, më e ulëta në rajon dhe shumë më e ulët sesa në BE, ishte 28.4%. Ndërkaq, norma e papunësisë ishte 30%. Në aspektin e cilësisë së punësimit, norma e punësimit joformal vlerësohet të jetë rreth 20% dhe ende mbetet një veti e rëndësishme e tregut të punës në Kosovë. Vet punësimi dhe punësimi pa pagë vazhdojnë të kontribuojnë me rreth 20% në punësimin e përgjithshëm. (Burimi: ASK/BB/UNDP: Rezultatet e Studimit të Fuqisë Punëtore në Kosovë në vitin 2013; korrik 2014)

janë vënë disa politika të rëndësishme sektoriale për të promovuar zhvillimin e sektorit privat dhe për të ndërtuar ura ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

Siç është vënë në pah në raportin dialogu Post 2015 në Kosovë, themelimi i tregut të punës që funksionon mirë do të varet nga kapaciteti i autoriteteve për të implementuar këto strategji dhe për të shtyer zbatimin standardet e punësimit. Kapaciteti për të siguruar furnizim pandërprerë me energji, qasje në kredi dhe infrastrukturë adekuate, si dhe për të përmirësuar praktikën e rregullatorit dhe zbatimin e kontratave do të jetë çelës për të garantuar një mjedis të shëndoshë biznesor. Autoritetet në Kosovë gjithashtu duhet të rrisin kapacitetin e tyre që të zhvillojnë dhe implementojnë më shumë politika dhe shërbime të tregut të punës që i përgjigjen kërkesave gjinore. Shërbimet Publike të Punësimit në Kosovë gjithashtu duhen fuqizuar në mënyrë që të sigurohet ofrimi i shërbimeve adekuate për bashkërendim të vendit të punës dhe përkrahja në gjetjen e vendit të punës. Inspektorati i Punës në Kosovë ballafaqohet me sfidën në aspektin e kapacitetit të vet institucional kur bëhet fjalë për mbrojtjen e drejtave elementare në punë, siç është theksuar në dialogun Post 2015.

Një vështirësi për qasje në punësim për njerëzit në Kosovë vjen për shkak të shkallës së lartë të ofertës së fuqisë punëtore krahas kërkesës së ulët për të. Kjo deri në një shkallë është si rezultat i sek-

torit privat të pazhvilluar sa duhet. Sektori privat vazhdon të jetë kryesisht i orientuar kah bizneset e shkallës së vogël dhe shërbimet me vlerë të shtuar të ulët. Diversifikimi në industritë prodhuese dhe ato shërbyese nuk ka filluar ende dhe ndërmarrjet ekzistuese në sektorin privat nuk kontribuojnë mjaftueshëm në eksport apo zëvendësim të importit.

Një tjetër pengesë ndërlidhet me shkathhtësitë joadekuate dhe arsimin joadekuate të fuqisë punëtore në lidhje me nevojat punëdhënësve. Studimet e bëra nga UNDP-ja dhe BB-ja tregojnë që përqindja e kompanive që konsiderojnë që shkathhtësitë dhe edukimi i punëtorëve në dispozicion nuk përputhet me nevojat e tyre sillet nga 37% deri në 60% varësisht nga madhësia kompanisë dhe burimi. Emigrimi jashtë kufijve i kapitalit njerëzor mund të ndikojë edhe më tej në mundësinë që punëdhënësit të përmbushin nevojat e tyre.

Norma e punësimit për femrat është 12.9% krahasuar me 44% për meshkujt, ndërkaq norma e papunësisë për femrat është 38.8%, ndërsa për meshkujt 26.9%. Norma e mosaktivitetit tek femrat është 78.9% krahasuar me 38.8% tek meshkujt. (Burimi: ASK/BB/UNDP: Rezultatet e Studimit të Fuqisë Punëtore të Kosovës në vitin 2013, korrik 2014.)

Indikatorët e tregut të punës tregojnë që qasja në punësim është më e ulët për gratë sesa për burrat. Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës lidhen me rolet e dhëna gjinore për gratë si kujdestare kryesore në familje si dhe cilësia e ulët e mundësive të punësimit, gjë që nga ana tjetër nuk krijon stimulimin e duhur për të marrë pjesë në tregun e punës. Gratë kalojnë rreth 80% të kohës së tyre duke bërë punë pa pagesë në shtëpi duke u kujdesur për fëmijët, të sëmurët dhe të moshuarit. Një faktor shtesë që ndikon në zhvillimin e karrierës së grave dhe në pjesëmarrjen në treg të punës është mungesa e inkurajimit për të kontribuar në të ardhurat e familjes. Faktori i fundit që ndikon negativisht që gratë mos të marrin rol aktiv në tregun e punës është krijimi i profesioneve stereotip për gratë dhe

11 Strategjia për zhvillimin e NVM-ve 2012-2016, Politika Industriale 2014, Programi për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (ARDP) 2007-2013 dhe Strategjia Sektoriale dhe Plani i Veprimit 2014-2020 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

12 Orgut Consulting AB: Profili Gjinor i Vendit: analiza e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë; prill 2014, f.18

13 Në të njëjtin vend, f. 19

14 Personat në moshën 15-24 vjeç.

15 ASK/BB/UNDP:Rezultatet e Studimit të Fuqisë Punëtore në Kosovë në vitin 2013; korrik 2014, f.2.

burrat që pasqyrohet nga shkollat profesionale ku regjistrohen më shumë meshkuj (71%) sesa femra (29%).

Me normën e papunësisë prej 55.9%, qasja në tregun e punës është më e ngadalta tek të rinjtë. Niveli i mos-aktivitetit tek të rinjtë, d.m.th. të rinjtë që nuk janë duke studiuar, punuar apo duke u trajnuar – është 35.3%. Edhe pse gjithnjë më shumë të rinj po përfundojnë shkollën e mesme të lartë dhe universitetin, ata aktualisht ballafaqohen me një fazë shumë të gjatë tranzicioni nga shkolla në punësim, gjë që ndikon negativisht në pjesëmarrjen e tyre në treg të punës.

Për më tepër, kapaciteti i organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve për të ndikuar në zhvillimet e politikave është aktualisht i limituar. Partnerët social duhet fuqizuar që të jenë në gjendje që të përfaqësojnë në mënyrë adekuate dhe të shërbejnë si duhet anëtarëve të vet dhe të angazhohen efektshëm në dialogun social. Përmbyllja e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në vitin 2013 nënvizon nevojën për themelimin e kornizave të shëndosha ligjore dhe institucionale për bisedime kolektive në nivele të ndryshme, si dhe për zhvillimin e sistemit të lidhjes industriale.

2.1.3 Arsimi

Kapitali njerëzor është element kyç për zhvillim ekonomik, politik dhe social. Kapitali njerëzor

ngritet kryesisht përmes edukimit apo trajnimit. Autoritetet në Kosovë kanë demonstruar kapacitetet për të promovuar qasjen në arsim dhe qasja universale në arsimin fillor gati është arritur. Gjithashtu ka pasur ngritje të vazhdueshme në numrin e nxënësve në arsimin sekondar e terciar në Kosovë; me një normë bruto të regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë prej 92% në vitin 2011-2012; duke qenë e mjaftueshme në nivel të kënaqshëm është norma më e lartë në Ballkanin Perëndimor. Ngjashëm, në mënyrë pozitive ka pasur gjithashtu rënie në nivelin e braktisjes së shkollës së mesme të lartë nga 3.1% në vitin 2009 në 2.5% në vitin 2011-2012. Ngjashëm, niveli i njohurive të shkrim-leximit është më i larta sesa në shumë vende në zhvillim dhe në nivel të njëjtë me mesataren në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore.

Sidoqoftë, është e vështirë të vlerësohet se deri në ç'skallë ndikojnë pozitivisht në zhvillim në Kosovë këto trende inkurajuese, pasi që ka të dhëna të kufizuara lidhur me cilësinë dhe relevancën e arsimit dhe trajnimeve të ofruara. Një sinjal që Kosova është duke u ballafaquar me sfida në këtë fushë është që në anketën e UNDP-së për RZHNJ-në është raportuar se shkathtësitë dhe edukimi i punëtorëve në dispozicion aktualisht është një kufizim kryesisht për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla e më pak për ndërmarrjet mikro. Cilësia dhe relevanca e trajnimeve të ofruara ndikohet nga kapacitetet e kufizuara institucionale për të zba-

88% e vajzave, krahasuar me 96% të djemve, u regjistruan në shkollimin e mesëm të lartë në vitin shkollor 2011-2012. Në të njëjtin vit, niveli i kalimit nga shkolla e mesme e ulët në atë të lartë ishte 85% për vajzat dhe 97% për djemtë. (Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT): Indikatorët Arsimor në Kosovë, 2009-10, 2010-11 dhe 2011-12.)

Vetëm 85% e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë ndjekin shkollimin fillor. Shifrat janë edhe më të ulëta për shkollimin e mesëm. Gjithashtu niveli i braktisjes së shkollës është më i lartë tek fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian. (Burimi: ASK: Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë: Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2013-2014, tetor 2014.)

16 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT): Indikatorët Arsimor në Kosovë, 2009/10, 2010/11 dhe 2011/12; qershor 2013, f. 71 dhe 86

17 Niveli i analfabetizmit në Kosovë është 3.8%, 80% e të cilëve janë gra. ASK: Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011

18 Ekzistojnë mungesa në të dhëna sa i përket të dhënave në nivel hyrës, nivel të rezultateve dhe përfundimeve për sistemin e edukimit dhe trajnimeve. Nuk ka të dhëna të mbledhura në mënyrë sistematike e të shpërndara në lidhje me numrin e studentëve që regjistrohen tek ofruesit privat të arsimit të lartë, apo për edukimin apo trajnimet e mbajtura nga ofruesit privat joformal të edukimit dhe trajnimeve (duke përfshirë OJQ-të) në aspektin e niveleve të pjesëmarrjes dhe orëve të trajnimit. Nuk ekzistojnë të dhëna lidhur me rezultatet e nxënies; d.m.th. ajo që nxënësit janë duke mësuar apo rezultatet e punësimit, nëse ata janë duke punuar dhe çfarë pune janë duke kryer. Nuk ka vlerësime ndërkombëtare funksionale siç janë: PISA, PIRLS, TIMSS për të matur shkathtësitë dhe kompetencat që ofrohen nga ofruesit për nivele të ndryshme të arsimit.

19 Strategjia Kosovare për Arsim 2011-2016; Korniza Kurrikulare e Kosovës për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm; Strategjia kombëtare për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës 2009-2014; Strategjia për integrim të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim 2009-2015; Plani kombëtar dhe komunal i veprimit për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve 2007-2009; Strategjia shkollore për promovimin e shëndetit 2007-2017.

tuar dhe monitoruar legjislacionin, politikat dhe strategjitë në fushën e arsimit që janë në harmoni me standardet ndërkombëtare. Elemente tjera që ndikojnë në cilësinë e arsimit janë mungesa e hapësirës fiskale për të alokuar më shumë resurse për arsim cilësor, përkrahja e pamjaftueshme për përmirësimin performancën në shkollë dhe zhvillimin profesional të mësimeve, si dhe di-

Kosova investon vetëm 4.9% të buxhetit të saj në arsim, krahasuar me mesataren prej 6% tek shtetet me nivel të lartë të ardhurash. (Burimi: MASHT: Indikatorët Arsimit në Kosovë, 2009-10, 2010-11 dhe 2011-12; qershor 2013, f.81.)

vergjenca ndërmjet kurrikulës shkollë dhe nevojave të tregut të punës.

Pabarazitë që ekzistojnë në qasjen në arsim ndikojnë negativisht tek fëmijët që jetojnë në zonat rurale, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në familjet e përjashtuara nga shoqëria; veçanërisht familjet rome, ashkali dhe egjiptiane. Mungesa e transportit është raportuar të jetë një nga arsyet

Norma bruto e regjistrimit në arsimin parashkollor për fëmijët e moshës 0 deri në 6 vjeç është 15.5%. (Burimi: Indikatorët Arsimit në Kosovë, 2009-10, 2010-11 dhe 2011-12; qershor 2013.)

kryesore për mos-shkuarje në shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara apo fëmijët në viset rurale. Arsyet tjera që ndikojnë negativisht në nivelin e regjistrimit, ndjekjes së shkollimit apo braktisjes për fëmijët nga familjet e përjashtuara nga shoqëria janë mungesa e resurseve të mjaftueshme financiare, martesat e hershme dhe përkrahja e pamjaftueshme prindërore për të inkurajuar edukimin; dy faktorët e fundit paraqiten veçanërisht tek familjet rome, ashkali dhe egjiptiane.

Ekzistojnë mangësi në legjislacion në lidhje me arsimin parashkollor dhe programet zhvillimore në fëmijëri të hershme. Përveç resurseve të kufizuara financiare dhe njerëzore për të ofruar programe parashkollë në emër të autoriteteve, gjithashtu ka mungesë të vetëdijesimit të prindërve lidhur me benefitet e mësimit të hershëm dhe zhvillimit në fëmijëri.

Ekzistojnë gjithashtu edhe pabarazi gjinore, veçanërisht në arsimin e mesëm.

2.1.4 Shëndeti

Kosova në një afat të shkurtër kohor ka themeluar një platformë institucionale dhe ligjore që mundëson një kornizë për zhvillimin e politikave për shëndetin publik në Kosovë. Aktualisht, autoritetet shëndetësore në Kosovë janë duke ndërmarrë reformë gjithëpërfshirëse të politikave shëndetësore; diçka që ka krijuar mjedis pozitiv për përmirësimin e cilësisë dhe mbulueshmërisë

Jetëgjatësia pas lindjes në Kosovë është rreth 70 vite. Shkaktar kryesor i vdekjes janë sëmundjet në sistemin e qarkullimit të gjakut, neoplazmat, gjendjet që lidhen me periudhën perinatale dhe sëmundjet në sistemin e frymëmarrjes. Sëmundjet në sistemin e frymëmarrjes janë shkaktar kryesor për morbiditet; veçanërisht tek të rinjtë. (Burimi: UNDP: Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2012.)

së shërbimeve shëndetësore, si dhe performancën e ofruesve të shërbimeve shëndetësore.

Pavarësisht nga zhvillimet pozitive në krijimin e bazës për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për njerëzit në Kosovë, ende ka sfida të shumëfishta kur është në pyetje qasja në këto shërbime. Edhe me përmirësimin e mbulueshmërisë së sigurimit shëndetësor që do të fillojë së hyri në fuqi në vitin 2016, 85% e popullatës ka vështirësi në qasjen në shëndetësi për shkak të kostos së barërave dhe 58% për shkak të kostos së vizitës së mjekut. Shpenzimet e larta nga xhepi i prekin joproporcionalisht grupet e përjashtuara për të cilët kostot e transportit gjithashtu paraqesin një barrierë. Për më tepër, gratë dhe grupet e përjashtuara nga shoqëria kanë vështirësi në qasje në shërbime shëndetësore për shkak të vetëdijesimit të ulët lidhur me të drejtat e tyre në shëndetësi, mangësive në njohuri lidhur me shëndetin dhe stigmave shoqërore.

Ekzistojnë sfidatë ndryshme në lidhje me kapacitetin e autoriteteve shëndetësore për të përmbushur obligimet e tyre ndaj popullit të Kosovës. Edhe pse 9% e buxhetit qendror ndahet për sektorin e shëndetësisë, duke përfshirë sektorin e shëndetësisë primare. Kjo konsiderohet si e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e shumëfishta, ka të ngjarë

që më shumë nevoja do të mund të përmbusheshin me një ndarje tjetër dhe menaxhim më efikas të resurseve në kuadër të sektorit të shëndetësisë. Me gjithë ekzistencën e kornizës mjaft gjithëpërfshirëse të politikave, autoritetet shëndetësore kanë arritur vetëm pjesërisht që të kenë sukses në përmbushjen e obligimeve të tyre, për shkak të mangësive në implementim, siç është pasqyruar në raportin dialogu Post 2015.

Një faktor kyç në zhvillimin e mëtutjeshëm të planifikimit të duhur, buxhetimit dhe monitorimit të kapaciteteve të autoriteteve shëndetësore është Sistemi Informativ Shëndetësor i fuqishëm. Sistemi aktual Informativ Shëndetësor ka kapacitete relativisht adekuate kur bëhet fjalë për analizë të të dhënave të grumbulluara, por do të përfitonte nga një sistem më i efektshëm i raportimit në kuadër të sektorit dhe nga koordinimi më i ngushtë brenda dhe jashtë sektorit.

Shëndeti seksual dhe reprodutiv (SHSE): Edhe me trendet në rënie të Raportit të Vdekshmërisë së Nënës (nga 23 në vitin 2000 në 10.5 në vitin 2012) dhe mortalitetit perinatal (nga 29.1 për 1000 lindje të gjalla në vitin 2000 në 16.3 për 1000 lindje të gjalla në vitin 2013 (Burimi: Ministria e Shëndetësisë, maj 2014); gjendja shëndetësore e nënës dhe fëmijës vazhdon të konsiderohet si më e dobëta në rajonin evropian. Përdorimi i kontraceptivëve dallon për nga përkatësia etnike dhe nga niveli i arsimit e statusi martesor. Norma e Prevalencës së Kontraceptimit (NPK) tregon një trend në rënie (nga 15% në vitin 2009 (Burimi: ASK: DHS) në 14% në vitin 2013 (Burimi: ASK: MICS). NPK-ja tek romët, ashkallitë dhe egjiptianët në vitin 2013 ishte pak më i lartë se tek popullata e përgjithshme, në vlerën 19%. Nevoja e paplotësuar për planifikim familjar është 9% për gratë në përgjithësi dhe 18% për gratë rome, ashkali dhe egjiptiane. Norma e lindjes nga adoleshentët dhe normat e bartjes së hershme të fëmijës janë 15% dhe 1% respektivisht, për popullatën e përgjithshme dhe 69% dhe 17% respektivisht, për gratë rome, ashkali dhe egjiptiane (Burimi: ASK: MICS). Kosova aktualisht është kategorizuar me normë të ulët të përhapjes së HIV-it në vlerën nën 1% tek popullata e përgjithshme dhe nën 5% tek të gjitha grupet me ekspozim të lartë ndaj mundësisë për infektim me HIV (Burimi: Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, janar 2015)

Përcaktuesit themelor të shëndetit, duke përfshirë ata që prekin prevalencën e Sëmundjeve të Pa-komunikueshme (SPK):

Në Kosovë, sfidat kryesore që ndërlidhen me sjelljet kanë të bëjnë me përdorimin e duhanit dhe dietat joadekuate.

Ndotja e ujit dhe tokës janë faktorë që ndikojnë negativisht në shëndetin e popullatës. Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit ka identifikuar 28 vende të kontaminuara në territorin e Kosovës. Në këto vende janë regjistruar nivele të larta të kontaminuesve që lidhen me nivelin e lartë të kontaminuesve në gjak, për shembull tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe tek gratë shtatzënë. Një tjetër rrezik për shëndetin është kontaminimi i ushqimit që rritet në ato vende. Sidoqoftë, nuk ekziston plan gjithëpërfshirës për adresimin e mbetjeve kimike apo për pastrimin e pikave të ndotura kimikisht. Nuk ka as ndonjë monitorim të ujërave tokësore dhe ujërave të mbetjeve urbane dhe industriale. Niveli i lartë i ndotjes së ajrit vlerësohet se kontribuon drejtpërdrejt në vdekjet e parakohshme. Rastet e reja të bronkitit kronik, pranimit në spital dhe vizitat emergjente shkaktojnë kosto të larta për sektorin shëndetësor publik. Edhe pse nuk ka vlerësim mbarëkësor për pabarazitë mjedisore, efektet e ndërlidhura shëndetësore dhe humbjet rezultuese ekonomike, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, personat e paarsimuar apo me nivel të ulët arsimimi dhe familjet me të ardhura të ulëta që jetojnë në komunat me zona të kontaminuara kanë ekspozim më të lartë ndaj rrezikut mjedisor për shkak të vendndodhjes së vendbanimeve të tyre. Pavarësisht nga fakti që rezultatet nga vlerësimi i në progres nga UNDP-ja dhe OBSH-ja lidhur me cënueshmërinë shëndetësore, ndikimi dhe adaptimi nuk janë dhënë ende, pritet që ndryshimi klimatik gjithashtu të prekë gjendjen shëndetësore në Kosovë. Për shembull, ekziston rreziku i rritjes së përhapjes së sëmundjeve të ndjeshme në kushte klimaterike, veçanërisht për shkak shpërndarjes së ndryshuar të vektorëve. Valët e të ngrorit dhe vërshimet janë kushte ekstreme të motit që lidhen me klimën dhe që paraqesin kërcënim për shëndetin.

Duke marrë në konsideratë shkaktarët kryesorë të vdekjes dhe morbiditetit dhe atë që e drejta në shëndetësi shtrihet tek përcaktuesit themelor të shëndetit, është argumentuar se autoritetet shëndetësore në Kosovë duhet të fuqizojnë kapacitetet dhe koordinimin e tyre, posaçërisht me sektorët e arsimit dhe mjedisit, për të implementuar politika

21 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/ Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (KEPA): Raporti për Gjendjen e Mjedisit 2011-2012; 2013.

22 Në të njëjtin vend

23 Banka Botërore: Analiza Mjedisore e Vendit-Kosova; Janar 2013

24 Në të njëjtin vend

gjithëpërfshirëse për shëndetin të cilat targetojnë këta përcaktues dhe adresojnë posaçërisht sfidat që lidhen me mjedisin fizik dhe sjelljet.

Reforma në shëndetësi në progres dhe Strategjia përkatëse për Shëndet 2015-2020 pritet të trajtojë disa, nëse jo të gjitha, nga sfidat e përmendura. Gjithashtu pritet që ajo do të mundësojë autoritetet shëndetësore që të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Cilësia e shërbimeve për SHSR në përgjithësi dhe për shërbimet e kujdesit maternal dhe neonatal në veçanti, ndikohet nga mungesa e udhëzimeve dhe protokolleve në njëri anë dhe nga mungesa e mekanizmave për detyrimin dhe përshtatjen me protokollin ekzistues nga personeli mjekësor dhe të tjerët. Koordinimi ndërmjet niveleve të ndryshme të shërbimeve gjithashtu ndikon në cilësinë e përgjithshme të shërbimeve.

Përveç fuqizimit të kapaciteteve të autoriteteve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore, është i domosdoshëm fuqizimi i kapaciteteve për të mundësuar ofrimin e një game të gjerë të shërbimeve. Për shembull, të gjitha qendrat e shëndetit primar nuk ofrojnë pakon e plotë të shërbimeve primare shëndetësore.

Në fund, vlerësimi i pamjaftueshëm i teknologjisë shëndetësore dhe mekanizmat për sigurimin e cilësisë janë duke ndikuar në transparencë dhe llogaridhënie të sistemit shëndetësor dhe duhet të jenë pjesë përbërëse e kulturës së sigurisë së pacientit.

2.1.5 Mjedisi

Kosova vuan nga ndotja e mjedisit dhe degradimi i resurseve natyrore që ndikojnë rëndë në mundësitë e jetesës dhe shëndetin publik dhe dëmton arritjet zhvillimore. Problemet kryesore mjedisore në Kosovë përfshijnë ndotjen e ajrit, pamjaftueshmërinë e ndotjes së ujit dhe degradimin e tokës.

Ndotja e ajrit është problem mjedisor kritik në zonat urbane, edhe pse më pak për Kosovën si tërësi. Burimet kryesore të ndotjes janë termocentralet e vjetra me thëngjill, zona e mihjes së thëngjillit, druri dhe linjiti që përdoret për ngrohje

të shtëpive, mihja dhe prodhimi i nikelit, komplekset industriale, fabrika e çimentos në Han të Elezit dhe karburantet me origjinë nga fosilet nga komunikacioni i rritur dhe automjetet e vjetra. Mangësitë në zbatimin e legjislacionit për mjedisin dhe në kontrollimin e industrisë, por gjithashtu teknologjitë joadekuate për prodhim dhe rritja e emisioneve jo-industriale kontribuojnë në ndotjen e ajrit në Kosovë.

Kosova gjithashtu ballafaqohet me cilësi dhe sasi jo-adekuate të burimeve të saj të ujit. Monitorimi kimik dhe bakteriologjik tregon që shumica e lumenjve në Kosovë janë të ndotur. Të dhënat nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik tregojnë se 74-90% e puseve ujore janë të kontaminuara dhe ka pasur raste të kontaminimit të furnizimit publik me ujë, kryesisht nga kontaminimi bakteriologjik e jo nga ai kimik. Sa i përket ndotjes së ujit dhe sistemeve të dobëta të ujërave të zeza, faktorët kontribuues përfshijnë menaxhimin joadekuat të sistemeve të furnizimit me ujë dhe sistemeve të ujërave të zeza, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe e skemave të monitorimit dhe sistemet joadekuate për menaxhimin e mbeturinave, që potencialisht mund të ndikojë në burimet e ujit të pijshëm. Menaxhimi joadekuat i mbeturinave është në fakt një nga sfidat kryesore mjedisore për shkak të mbulueshmërisë së ulët dhe kushteve të papërshtatshme për grumbullim, klasifikim, riciklim dhe menaxhim të mirëfilltë për pothuajse të gjitha llojet e mbeturinave të ngurta.

Pyjet mbulojnë rreth 44% të territorit dhe pësojnë nivel të lartë dhe të parregulluar të shpyllëzimit. Kjo, së bashku me deponitë industriale dhe ato sanitare, erozioni dhe zgjerimi i paplanifikuar i vendbanimeve, kontribuojnë në degradimin e tokës në Kosovë. 28 vendet e kontaminuara të identifikuara nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (KEPA) janë një sfidë tjetër madhore që ka qenë vështirë për të trajtuar për shkak të nivelit të ulët të implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedis dhe statusit të paqartë ligjor të disa vendeve industriale, ndër faktorë të tjerë.

Ndryshimi klimatik ka të ngjarë t'i shtohet sfidave aktuale mjedisore në Kosovë. Parashikimet për të gjithë Ballkanin Perëndimor tregojnë temperatu-

25 Banka Botërore: Analiza Mjedisore e Vendit-Kosova; Janar 2013

26 Shkolla për Biznes e Universitetit të Gotenburgut, Ekonomia dhe Ligji: Analiza Mjedisore dhe Klimatike e Kosovës; mars 2008

27 Banka Botërore: Analiza Mjedisore e Vendit-Kosova; Janar 2013

ra më të larta dhe më shumë çrregullsi në reshje, mundësi të ekspozimit ndaj rreziqeve si thatësi-
ra, vërshimet dhe zjarret pyjore. Ky ndryshim vë
në rrezik mjetet e jetesës që mbështetet në resurse
natyrore siç janë bujqësia dhe pylltaria dhe rritë
cenueshmërinë e atyre që jetojnë në zona me rrezik
nga fatkeqësitë natyrore si rrëshqitjet e tokës dhe
vërshimet.

Kushtet e dobëta të banimit, mbipopullimi dhe
zvogëlimi i mundësisë për të përballuar shërbimet
bazike çon në gjendjen ku grupe të caktuara të sho-
qërisë të preken joproportionalisht nga rreziqet
mjedisore. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
dhe ata që jetojnë në vende me ajër të ndotur janë
veçanërisht të cenueshëm si dhe grupet tjera të
përfshiuara të shoqërisë. Niveli i ulët i njohurive
tek publiku i përgjithshëm për rreziqet mjedisore
dhe mungesa e ndikimit në shoqëri gjithashtu rritë
cenueshmërinë e disa grupeve të përjashtuara nga
shoqëria. Pabarazitë ndaj rreziqeve mjedisore
nuk janë përfshirë në ndonjë strategji apo politikë
publike dhe aktualisht nuk ka në dispozicion asnjë
vlerësim mbarë kosovar lidhur me pabarazitë
mjedisore, efektet e ndërlidhura shëndetësore dhe
humbjet rezultuese në ekonomi.

Autoritetet në Kosovë kanë zhvilluar disa do-
kumente politikash të rëndësishëm për të adre-
suar sfidat e sipërpërmendura. Në mënyrë më
specifike, "Strategjia Kosovare për Mjedisin 2011-
2021," "Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin
2011-2015" dhe "Strategjia Kornizë për Ndry-
shimet Klimatike 2014-2024." Ato gjithashtu
janë të përfshira në një proces në progres e sipër
të harmonizimit të kornizës legjislativ me EU-
acquis. Sfida kryesore tani është implementimi
i kornizës së politikave dhe detyrimi i zbatimit të
legjislationit.

2.1.6 Sundimi i ligjit

Viteve të fundit është arritur progres i konsider-
ueshëm në fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë.
Institucionet kyçe si Ministria e Drejtësisë, In-
stituti Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i
Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Oda
e Avokatëve të Kosovës kanë punuar së bash-
ku me komunitetin ndërkombëtar për të vendo-
sur kornizën ligjore në harmoni me standardet
ndërkombëtare dhe rajonale të drejtave të njeriut,
duke përfshirë edhe fushën e drejtësisë për të mi-
tur. Hapa të konsiderueshëm janë bërë në fushën

e sistemit të drejtësisë për të mitur në Kosovë në
lidhje me kornizën ligjore, strukturën institucio-
nale dhe kapacitetet për implementimin e lig-
jit. Në vitin 2014, UNICEF ka kryer shqyrtimin
gjithëpërfshirës ligjor të legjislationit kosovar
për të harmonizuar atë me instrumentet kryesore
ndërkombëtare duke përfshirë Konventën për të
Drejtat e Fëmijës dhe legjislationin e aplikueshëm
të BE-së.

Të dhënat nga viti 2008 tregojnë se 46% e grave
pësojnë nga dhuna në familje së paku njëherë
gjatë jetës së tyre, krahasuar me 40% të bur-
rave. 91% e kryerësve të dhunës në familje, sipas
raporteve të policisë nga viti 2013, janë burra.
(Burimi: Orgut Consulting AB: Profili Gjiner i
Vendit: analiza e dallimeve gjinore në të gjitha
nivelet në Kosovë; prill 2014)

Me gjithë reformat e kohëve të fundit dhe zhvilli-
met në sistemin e drejtësisë, autoritetet për Sun-
dim të Ligjit duhet të bëjnë më shumë dhe me ritëm
më të shpejtë. Disa aktorë ndërkombëtarë siç janë
Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës,
Zyra e Komisionarit të Lartë të KB-së për të Dre-
jta të Njeriut (OHCHR) dhe KE-ja kanë shprehur
shqetësime lidhur me qasjen në drejtësi në Kosovë,
duke përfshirë të drejtat pronësore.

Ekziston vetëdijesim i kufizuar tek popullata në
Kosovë lidhur me procedurat ligjore; posaçërisht
minoritetet hasin në barriera në qasje në sistem.
Vetëm rreth gjysma e komunave në Kosovë kanë
Zyrat për Ndihmë Juridike.

Për më tepër, edhe pse ekzistojnë njësitë gjinore
apo pikat e kontaktit në kuadër të policisë dhe

Rreth gjysma e popullsisë së Kosovës ka per-
ceptimin se ka korrupsion në shkallë të lartë në
shëndetësi, dogana dhe institucione tjera pub-
like dhe afërsisht 10% e popullatës në moshë të
rritur raporton se janë ekspozuar drejtpërdrejt
apo tërthorazi ndaj përvojave të mitosjes me
zyrtarë publik (Burimi: Zyra e KB-së për Droga
dhe Krime (UNODC): Korrupsioni në Kosovë:
Mitosja siç është përjetuar nga popullata; 2011).
Bizneset gjithashtu pohojnë se janë sprovuar me
mitosje: 11% e atyre që kanë kontakte me ad-
ministratën publike pohojnë se paguajnë së
paku një herë në vit për mito dhe shumë nga
ta përmendin veprimin e tillë me një rregullsi të
konsiderueshme (Burimi: UNODC/ASK: Biznesi,
Korrupsioni dhe Krimi në Kosovë - ndikimi i mi-
tosjes dhe krimeve tjera në ndërmarrjet private;
2013).

gjyqësorit, përkrahja e mirëfilltë shpesh nuk arin tek gratë dhe vajzat që kanë rënë ndesh me ligjin. Pavarësisht nga barazia de jure për burrat dhe gratë, de facto diskriminimi kundër grave vazhdon. Gratë kanë tendencë të kenë qasje të zvogëluar në drejtësi dhe në mjetet e duhura lig-

Format dominuese të krimit të organizuar në Kosovë janë TQNJ-ja dhe trafikimi i drogës.

jore të garantuara me ligj dhe kompensimet për krimet e përjetuara nuk janë adekuate. Modele të ngjashme duket se ekzistojnë edhe për personat me aftësi të kufizuara dhe romët, ashkalitë e egjiptianët (posaçërisht gratë) të cilët nuk përfitojnë nga mbrojtja adekuate e të drejtave të njeriut. Gëzimi i efektshëm e të drejtave të grave deri në një shkallë ndikohet nga zakonet dhe tradita patriarkale, por gjithashtu përjetësohet nga Sundimi i dobët i Ligjit.

Qasja në drejtësi pengohet edhe më tej nga grumbullimi i lëndëve të pakryera të gjykatave, së bashku me ekzekutimin e ngadalshëm të vendimeve të gjykatës dhe me perceptimin për shkallë të lartë të korrupsionit në sektorë të caktuar, prek të drejtat ligjore të njerëzve në Kosovë. Këto elemente të kombinuara ndikojnë në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e një sistemi efektiv dhe të pavarur të Sundimit të Ligjit për garantimin e qasjes më të mirë në drejtësi për të gjithë njerëzit dhe për procesin e integritetit në BE për Kosovën, ka pasur dhe vazhdon të ketë fokusim të fortë në fuqizimin e kapaciteteve etike dhe profesionale të autoriteteve në mënyrë që të mundësohet atyre përmbushja e obligimeve të tyre. Është gjithashtu e rëndësishme që të hapen institucionet kosovare për sundim të ligjit për gjeneratën e re të profesionistëve kosovarë ligjorë, posaçërisht për ata individë që kanë studiuar jashtë vendit. Janë zhvilluar disa strategji sektoriale të rëndësishme në fushat e luftës kundër korrupsionit, luftës kundër krimit të organizuar, luftës kundër trafikimit të drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore (TQNJ), ndër të tjera, dhe janë krijuar mekanizmat e ndryshëm koordinues për implementimin e tyre. Ekziston një numër mundësish për UNKT-në që të fuqizoj këta mekanizma. Njashtu, në kuadër të kontekstit më të gjerë të

Kornizës Strategjike të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, UNKT-ja gjithashtu do të fuqizojë bashkëpunimin e saj dhe do të shfrytëzojë kapacitetet në dispozicion nga seksioni i UNMIK-ut për Sundim të Ligjit.

Megjithatë, para se të jenë në gjendje që me të vërtetë të promovojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe të sigurojnë qasje më të mirë në drejtësi për të gjithë njerëzit në vend, autoritetet për Sundim të Ligjit në Kosovë duhet të përmbushin standardet minimale të të drejtave të njeriut. Ekzistojnë sfida të shumta në nivelin institucional, duke përfshirë përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve relevante në fushën e Sundimit të Ligjit për të përparuar në shkëmbimin e të dhënave dhe menaxhimin e rasteve, veçanërisht brenda policisë dhe ndërmjet policisë, gjykatave dhe prokurorive. Ngritja e kapaciteteve të personelit administrativ në të gjitha institucionet e drejtësisë për të garantuar që të gjitha procedurat mbahen në kohë, në mënyrë transparente dhe adekuate është një sfidë tjetër, pasi që mbyll hendekun në legjislacion dhe politikat që lidhen me të, për shembull krimi i organizuar, drejtësia për të mitur dhe sigurimi i alokimeve të mjaftueshme buxhetore për to dhe i pronësisë së implementimit të strategjive të sektorëve të ndryshëm.

E rëndësishme së veçantë është fuqizimi dhe përkrahja e Këshillit Kundër Korrupsionit për implementimin e strategjisë së re kundër korrupsionit. Njashtu është edhe përkrahja për Grupin Punues Ndër-ministror për ballafaqimin me të Kaluarën dhe për Pajtim për përpilimin dhe aprovimin e strategjisë për ballafaqimin me të kaluarën përtej ndjekjes së krimeve të luftës dhe me pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile.

Ligji i Kosovës për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale në Kosovë detyrojnë kuotën prej 30% për të garantuar qasje për pjesëmarrje të grave në kuvendet qendrore dhe lokale. Pa këtë, zgjedhjet e fundit do të kishin rezultuar me vetëm 15% të grave të zgjedhura si deputete në nivelin qendror. Vetëm dy nga ministrat aktual janë gra dhe 7% e të gjitha pozitave vendim-marrëse në kuadër të ministrave në Kosovë mbahen nga gratë. (Burimi: ZKM/ABGJ: Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore dhe lokale dhe në parti politike në Kosovë, tetor 2014.)

28 UNICEF: Studimi i nivelit bazë për Dhunën në Familje dhe Dhunën e Bazuar në Gjini; 2013.
29 ORGUT Consulting AB: Profili gjinor i vendit për Kosovën: analizë e diferencave gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë; prill 2014

Dy elemente shtesë të rëndësishme në përmbushjen e obligimeve të autoriteteve për të mbështetur të drejtat ligjore dhe procedurale të njerëzve në Kosovë është sigurimi i fuqisë punëtore të profesionistëve ligjorë me njohuri të duhura të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare që lidhen me Sundimin e Ligjit dhe zbatimin efektiv të ligjit në pjesët veriore të Kosovës.

2.1.7 Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut për gratë

Korniza ligjore dhe organizative e Kosovës për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave është relativisht gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare, si CEDAW, Pekin+20, RSKB 1325 dhe Konventa e Stambollit, ndër të tjera, krahas acquis për barazi gjinore të BE-së. Agjencia për Barazi Gjinore e Kosovës është themeluar si organ ekzekutiv me qëllim kryesor, por jo ekskluzivisht, koordinimin dhe monitorimin e implementimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe strategjive përkatëse dhe planeve të veprimit, me përkrahje nga Zyrat për Barazi Gjinore në kuadër të autoriteteve qendrore dhe lokale.

Megjithatë, edhe pse korniza ligjore e Kosovës ofron de jure barazi për burrat dhe gratë, de facto diskriminimi kundër grave vazhdon, duke rezultuar në mbrojtje joadekuata të disa të drejtave elementare të njeriut të garantuara me ligjet e Kosovës. Përveç pabarazive tashmë të përmendura në pjesët paraprake, krahasuar me burrat, gratë në Kosovë mbesin me përfaqësim të ulët, si në aspektin cilësor ashtu edhe në atë sasior në proceset vendim-marrëse në të gjitha nivelet. Një pengesë për pjesëmarrjen e grave në proceset vendim-marrëse është roli gjinor i perceptuar tradicionalisht në Kosovë. Njerëzit vazhdojnë të lidhin udhëheqjen me burrat, që është arsyeja pse gratë kanë vështirësi për të marrë pjesë ashtu si duhet në vendim-marrje në kuadër të partive politike dhe arsyeja pse ka më pak femra në pozitat vendim-marrëse në institucionet qendrore dhe ato

lokale.

Gratë në Kosovë gjithashtu pësojnë nga shkeljet tjera të të drejtave të tyre njerëzore përmes dhunës së bazuar në gjini (DHBGJ). Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, së bashku me "Programin kombëtar për mbrojtjen nga dhuna në familje," është mjaft gjithëpërfshirës. Përveç kësaj, koordinimi ndërmjet autoriteteve relevante është përmirësuar viteve të fundit. Sidoqoftë, implementimi mbetet sfidë, veçanërisht në lidhje me qasjen në drejtësi, rehabilitim dhe riintegrim. Ekzistojnë vend strehime për gratë dhe fëmijët që kanë pësuar DHBGJ, por që të dyja strehimi dhe shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimit janë të financuara shumë dobët. Ekzistojnë vetëm shërbime të kufizuara për kryerësit e dhunës dhe nuk ka shërbime strehimi në pjesën veriore të Kosovës apo për burrat dhe djemtë mbi moshën 12 vjeçare. Stigma dhe perceptimet e gabuara për atë se çka është sjellje e pranueshme ndërmjet partnerëve janë barriera në luftimin e DHBGJ-së dhe në ofrimin e shërbimeve për viktimat. Këto perceptime gjithashtu përfshijnë dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin. Anketimi i nivelit bazë i kryer në vitin 2013 nga UNICEF-i dhe partnerët ka nxjerrë në pah një shqetësim të madh në lidhje me pranimin e gjerë të dhunës në familje dhe DHBGJ-së, duke përfshirë pranimin nga të rinjtë dhe të rejtat.

Kur shikohet fuqizimi ekonomik i grave përtej normave të pjesëmarrjes në tregun e punës, duhet venë në pah që më pak se 10% e bizneseve në Kosovë udhëhiqen nga gratë apo janë në pronësi të grave. Bizneset e tyre gjithashtu janë më të vogla sesa bizneset që udhëhiqen nga burrat (gratë kanë mesatarisht 3.07 punëtorë krahasuar me 5.27 punëtorë në bizneset e udhëhequra nga burrat). Qasja në kredi apo hua është pengesë e madhe për rritjen e bizneseve që udhëhiqen apo janë në pronësi të grave: vetëm 3% e huave komerciale bankare janë dhënë për gratë, kryesisht për shkak të mungesës së kolateralit. Edhe pse korniza ligjore ofron barazi për burrat dhe gratë për të drejtat pronësore, gratë shpesh humbasin trashëgiminë e

30 ASK: Migrimi i Kosovarëve: prill 2014

31 Banka Qendrore e Kosovës: Raporti Vjetor; qershor 2014

32 ASK: Migrimi i Kosovarëve: prill 2014

33 Statistikat nga Eurostat për azilkërkuesit.

34 Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

35 ASK: Migrimi i Kosovarëve: prill 2014

36 IOM Statistikat për Kthimin e ndihmuar vullnetar dhe riintegrim

37 Të dhënat e ndara nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Nënshitetësi, Azil dhe Migrim.

38 UNICEF: Raporti për nivelin bazë për testimin e udhëzimeve për riatdhësim në dy komuna (Gjakovë dhe Prishtinë), janar 2015.

tyre në të mirë të vëllezërve të tyre për të mbrojtur interesat e familjes. Në vitin 2014, vetëm 8% e pronave, duke përfshirë pronësinë e tokës, ishin në pronësi të grave, duke u lënë burrave në kontroll 92% të pronave kolaterale në Kosovë. Ka një plan veprimi për fuqizimin ekonomik të grave, por autoritetet kanë mbetur prapa në implementim.

2.1.8 Migrimi

Kosova ballafaqohet me përzierje të lëvizjeve të migrimit përmes kanaleve të rregullta e të parregullta si vend origjine dhe si vend transit dhe në një shkallë më të vogël, si vend destinacion për azilkërkues.

Si vend i origjinës, Agjencia e Statistikave të Kosovës vlerëson se afërsisht 550,000 kosovarë kanë migruar nga Kosova gjatë periudhës nga 1969-2011, me një përfaqësim pak më të lartë të burrave me 57%, për shkak të dominimit të migrimit për qëllime pune. Nëse përfshihet numri i vlerësuar i fëmijëve të lindur jashtë vendit me së paku njërin prind me origjinë kosovare, numri i diasporës kosovare arrin shifrën afërsisht 700,000. Diaspora kosovare luan një rol të rëndësishëm duke kontribuar në zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin e niveleve të cenueshmërisë përmes investimeve dhe remitencave që arrijnë vlerën 621 milion euro – rreth 12.5% e BPV-së në vitin 2013. Megjithatë, mbetet mjaft shqetësuese humbja e kapitalit njerëzor dhe emigrimi i segmenteve të popullatës me nivel të lartë të edukimit dhe shkathtësive.

Shkaktarët kryesor për migrimin nga Kosova si vend origjine përfshijnë faktorin tërheqës të ribashkimit familjar (46%) si dhe faktorët shtytës nga papunësia dhe arsyet tjera ekonomike (35%), arsyet politike apo arsyet e ndërlihdura me konflikt (8%), mungesa e mundësive për edukim relevant (1%) dhe arsye tjera (10%). Me gjithë stabilitetin e përmirësuar politik dhe social në Kosovë, ende vazhdon të ketë valë të azilkërkuesve me origjinë kosovare në vendet e BE-së. Që nga vitet e hershme të 2010-ve, numri vjetor i azilkërkuesve ka arritur në më shumë se dyfishin e asaj kohe, nga afërsisht 10,000 në vitin 2011 dhe 2012 në mbi 26,000 në vitin 2014, me numrin më të madh të azilkërkuesve në Hungari (11,220) dhe Gjermani (8,920) të pasuar nga Franca, Suedia dhe Austria. Rritja e numrit të azilkërkuesve nga Kosova është

duke vazhduar gjatë vitit 2015 për shkak të faktorëve të sipërpërmendur tërheqës dhe shtytës. Kur shikohet Kosova si vend transit dhe vend destinacioni, faktori kryesor tërheqës është pozita gjeografike e Kosovës në pjesën jug-lindore të Evropës e kufizuar me Shqipërinë, Malin e Zi, IRJM-në dhe Serbinë. Kjo vendndodhje lehtëson kalimin transit të migruesve të rregullt dhe të parregullt për në BE dhe kufijtë poroz gjenerojnë fluks të migruesve të parregullt që kalojnë këtë zonë. Që nga viti 2009, kur autoritetet kosovare kanë marrë përsipër përgjegjësinë mbi Përcaktimin e Statusit të Refugjatit, janë dorëzuar gati 700 kërkesa për azil, nga të cilat vetëm për 5 është dhënë mbrojtja shtesë.

Kosova është bërë vend destinacioni për migruesit që kthehen nga shtetet përreth, BE-ja dhe Amerika Veriore të cilët janë larguar nga Kosova gjatë dy valëve të mëdha në vitet e hershme të 90-tave dhe gjatë konfliktit në vitin 1998-1999. Në mes viteve 1999 dhe 2014 Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) ka ndihmuar gjithsej 203,294 kthime vullnetare në Kosovë; duke përfshirë 181,561 kthime masive vullnetare gjatë periudhës 1999-2001. Që nga viti 2002, IOM-i ndihmon mesatarisht 2000 kosovarë në vit për kthim vullnetarë dhe riintegrim. Përveç kthimeve vullnetare, ka edhe një numër të kthimeve të detyruara për në Kosovë çdo vit nga shtetet evropiane përmes marrëveshjeve të ripranimit. Më konkretisht, në vitin 2014 kishte 1,292 kthime vullnetare të ndihmuara dhe 3,318 kthime të detyruara në Kosovë. Numri i kthimeve të detyruara pritet të rritet konsiderueshëm nga viti 2015 e më tutje pasi që shumica dërmuese e azilkërkuesve nga Kosova nga vala e sipërpërmendur do të kthehen. Për të përkrahur procesin e riintegrit të personave që detyrohen të kthehen në Kosovë, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) mbështetet në udhëzimet për riintegrim dhe sistemin e monitorimit që janë zhvilluar me asistencën teknike të UNICEF-it. Përgjithësisht social i këtij grupi të veçantë të familjeve dhe fëmijëve që kthehen në Kosovë është shumë shqetësues.

2.2 Prioritetet ekzistuese politike dhe zhvillimore

Në gjysmën e parë të vitit 2015, Kosova është në proces të zhvillimit të një dokumenti gjithëpërfshirës planifikues, "Strategjia Kombëtare për Zhvillim" (SKZH). SKZH-ja nuk do të zëvendësojë

strategjitë e tanishme dhe të ardhme sektoriale, por do të fokusohet në dy objektiva të përgjithshme që konsiderohen nga autoritetet kosovare se kërkojnë vëmendjen e nivelit më të lartë, konkretisht: rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe Integrimin Evropian. SKZH do të bazohet në katër shtylla: 1) Qeverisja e mirë dhe Sundimi i Ligjit; 2) Kapitali njerëzor dhe kohezioni social; 3) Konkurrueshmëria e sektorit privat; dhe 4) Infrastruktura mundësuese. Vegla planifikuese tjetër e referuar për përcaktimin e prioritetëve në kuadër të kornizës së PPZH-së është KAMSH-i, të cilën autoritetet e zhvillojnë në mënyrë periodike në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhim të Financave Publike dhe Agjendat Legjislative vjetore. Me gjithë polarizimet e përhershme, ende ka konsensus politik sa i përket integritimit në BE. Marrëveshjet si MSA-ja të negociuara ndërmjet BE-së dhe Kosovës dhe Marrëveshja e parë për parimet që drejtojnë normalizimin e marrëdhënieve (marrëveshja e Brukselit) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në prill të vitit 2013, si dhe marrëveshja pa-suese në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet këtyre territoreve, me gjasë do të drejtojnë përcaktimin e prioritetëve të autoriteteve dhe komunitetit ndërkombëtar në Kosovë në të ardhmen e afërt. Dokumenti strategjik i udhëhequr nga BE-ja që rregullon përkrahjen e tyre për Kosovën

UNKT-ja ka punuar së bashku me autoritetet për të zhvilluar planet lokale të veprimit në 19 komuna. Në 16 komuna janë mbajtur proceset konsultative dhe janë inkorporuar në proceset e zhvillimit të politikave.

është Dokumenti Indikativ Strategjik i BE-së për Kosovën 2014-2020.

Në nivelin global, Grupi Punues i Hapur për Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore (OQZH) riafirmoi përkushtimin për të implementuar në tërësi Deklaratën e Rios, Agjendën 21, Planin e Implementimit të Samitit Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Deklarata e Johannesburgut dhe Plani i Implementimit) me të gjitha shtetet anëtarë që morën pjesë. Ai gjithashtu riafirmoi përkushtimin për implementimin e plotë të Programit për Veprim për Vendet më së paku të Zhvilluara për dekadën 2011-2020 (Programi i Stambollit për Veprim), Programi Almati i Veprimit: Adresimi i nevojave të veçanta të vendeve në zhvillim pa dalje në det në kuadër të Kornizës së Re Globale për Bashkëpunim në Transportin Transit për ven-

det në zhvillim pa dalje në det dhe ato transit. Ai riafirmoi zotimet në rezultatet e të gjitha konferencave dhe samiteve madhore të Kombeve të Bashkuara në fushat ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke përfshirë Deklaratën e Milenium-it të Kombeve të Bashkuara, Rezultatit të Samitit Botëror të vitit 2005, Konsensusin Monterei të Konferencës Ndërkombëtare për Financimin për Zhvillim, Deklaratën e Dohas për Financimin për Zhvillim, zotimet e Asamblesë së Përgjithshme për Objektivat Zhvillimore të Mileniumit, Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullatën dhe Zhvillimin.

Dokumenti i Rezultateve nga ngjarja e veçantë e shtatorit 2013 për të çuar deri në fund përpjekjet e bëra drejt arritjes së Objektivave Zhvillimore të Mileniumit u riafirmua, ndër të tjera, vendosmëria për të bërë një agjendë të fuqishme zhvillimore post-2015. Përkushtimi për migrimin dhe zhvillimin u riafirmua në Deklaratën nga Dialogu i Nivelit të Lartë për Migrimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar.

Kosova ishte pjesë e konsultimeve Post 2015 që nga viti 2003 dhe vëzhgues në disa nga ngjarjet e përmendura më lartë. Përveç këtyre kornizave më të gjera të politikave (globale dhe lokale), ka një numër të madh të strategjive sektoriale që janë të rëndësishme për UNKT-në që tregojnë në mënyrë të detajuar objektivat e dakorduara nga palët e ndryshme të interesit nga institucionet kosovare, OSHC-të dhe komuniteti ndërkombëtar.

2.3 Vlera e shtuar e Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Pas mbi një dekade të pranisë së tyre në Kosovë, agjencitë e KB-së, fondet dhe programet, të mbledhur nën ombrellën e UNKT-së, janë partnerë të vendosur në Kosovë, të njohur si partnerë të besueshëm dhe serioz në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale. Kjo është rezultat i përvojës dhe ekspertizës së tyre globale, partneriteteve të krijuara me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe paanshmërisë së njohur të tyre. Pavarësisht nga shumë çështje në pritje të cilat

Janë organizuar 9 konsultime me grupe të përjashtuara nga shoqëria; janë implementuar dhjetë iniciativa për adresimin e nevojave të grupe të përjashtuara nga shoqëria dhe 44 iniciativa për ngritje kapacitësh me OSHC-të.


kërkojnë përkrahje të vazhdueshme, komuniteti ndërkombëtar është duke u ngushtuar; me këtë edhe shumica e përkrahjes financiare të investuar në Kosovë.

Si e tillë, UNKT-ja është e pozicionuar mirë për të adresuar sfida të shumta në agjendën zhvillimore të Kosovës në mënyrën më efikase, me harmonizimin e vet me prioritetet zhvillimore të Kosovës në kapitullin e ri të diskutimeve Post 2015 dhe me

performancën e ripërtëritë të sistemit të KB-së. KB-ja vazhdon të demonstrojë përparësitë e saj krahasuese në gjashtë pozita kyçe (Figura 1):

Këto përparësi krahasuese, të kombinuara me fuqinë e secilës agjenci, fond apo program të KB-së, në fushat e tyre përkatëse tematike, i jep UNKT-së vlerë të madhe të shtuar. Kjo vlerë e shtuar është bërë e vërtetë gjatë implementimit të PPZH-së së UNKT-së 2011-2015 përmes implementimit

Figura 1



Rreth 30 raporte janë përpiluar dhe shtatë sisteme informimi janë fuqizuar me përkrahje nga UNKT-ja

të Iniciativave të Përbashkëta dhe përpjekjeve të përbashkëta, për shembull për advokim në fushat e DHBGJ-së dhe drejtësisë tranzicionale.

Ka pasur progres në fuqizimin e kapaciteteve në aspektin e raportimit, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë. UNKT-ja e ka përkrahur Agjencinë për Statistika të Kosovës dhe autoritetet tjera relevante për të përpiluar raporte dhe për të përmirësuar sistemet aktuale të informatave për t'iu mundësuar atyre që të ofrojnë të dhëna në çdo moment, të ndara sipas gjinisë, moshës, grupeve të minoriteteve etnike, ndër të tjera.

UNKT-ja ka punuar me autoritetet në nivel lokal në zhvillimin e planeve lokale të veprimit, duke përfshirë ato për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (ZRRF) për mjedisin lokal dhe për mbrojtjen e resurseve natyrore.

Ajo gjithashtu ka implementuar iniciativa për të adresuar nevojat e grupeve të përjashtuara nga shoqëria, duke përfshirë gratë, dhe për të ngritur kapacitetet e OSHC-ve për të bërë të njëjtën gjë. Si përfundim UNKT-ja ka përkrahur OSHC-të dhe komunitetet lokale në implementimin e strategjive për komunikim për të promovuar ndryshimet në sjellje që lidhen me shëndetin dhe mjedisin.

33 fushata sensibilizimi, 60 seanca me komunitet dhe nëntë iniciativa për advokim janë përkrahur nga UNKT-ja.

4. PPZH e UNKT-së


Në procesin e vendosjes se si të kontribuohet më së mirë në adresimin e shumë sfidave që lidhen me zhvillim dhe me të drejtat e njeriut në Kosovë, UNKT-ja ka aplikuar kornizën analitike në vijim (Figura 2). Kriteret kryesore për identifikimin e fushave prioritare për PPZH-në 2015-2020 të UNKT-së janë paraqitur si tre rathë:

1. *Mangësitë në arritjen e zhvillimit ndërkombëtar dhe standardeve të të drejtave të njeriut: Analiza e gjendjes dhe e shkaktarëve ka inicuar një platformë për të identifikuar zbrazëtitat më të mëdha në arritjen e zhvillimit ndërkombëtar dhe të standardeve të të drejtave të njeriut, si dhe pengesat në progresin drejt mbylljes së këtyre zbrazëtitave*
2. *Vlera e shtuar e UNKT-së: Vlera e shtuar e UNKT-së duhet kuptuar si vlerë që UNKT-ja mund të ofrojë duke punuar së bashku dhe jo si një agjenci, fond apo program i vetëm.*
3. *Harmonizimi i prioriteteve ekzistuese politike dhe zhvillimore: Ky harmonizim duhet kuptuar ose si kontribut ose si plotësim në objektivat zhvillimore të përcaktuara nga autoritetet së bashku me palët tjera të interesit në Kosovë.*

Fushat kryesore strategjike janë ato ku përbushen këto tri kriteret; d.m.th. aty ku ka zbrazëtitë në arritjen e zhvillimit ndërkombëtar dhe standardeve të drejtave të njeriut; aty ku UNKT-ja të bashkuar mund të ofrojë vlerën më të lartë të shtuar; dhe aty ku ka ose kontribut ose plotësim në prioritetet ekzistuese politike dhe zhvillimore. Ekzistojnë zbrazëtitat të identifikuar në zhvillim dhe në të drejta të njeriut, si dhe prioritetet politike dhe zhvillimore që nuk janë përfshirë në fushat prioritare finale të PPZH-së së UNKT-së dhe në iniciativat strategjike, pasi që, për shembull, UNKT-ja si grup mund të mos jetë në gjendje të ofrojë vlerën e shtuar për adresimin e zbrazëtitës.

Është e rëndësishme që të qartësohet që PPZH 2016-2020 e UNKT-së nuk përfshin iniciativat e agjencive individuale, por i dallon fushat prioritare për bashkëpunim strategjik të UNKT-së drejt realizimit të objektivave të përbashkëta, parimisht përmes programeve të përbashkëta dhe advokimit të përbashkët. Domethënë, PPZH 2016-2020 e UNKT-së duhet të shihet si plotësim i planifiki-

Figure 2



meve strategjike të secilës agjenci, programi apo fondi individual të KB-së, që operon në Kosovë. Duhet vënë në pah që këto kriteret nuk janë statike në kohë; zbrazëtitat mund të zgjerohen apo të mbyllen, prioritetet politike dhe zhvillimore mund të ndryshojnë dhe vlera e shtuar e UNKT-së mund të rritet apo zvogëlohet. Prandaj UNKT-ja duhet të monitorojë këto kriteret dhe ndryshimet e mundshme dhe të jetë e gatshme që të përshtatë këto fusha prioritare dhe strategjitë e implementimit sipas rrethanave.

3.1 Rezultatet e pritura nga PPZH-ja

Bazuar në këtë analizë dhe në konsultim të ngushtë me autoritetet në Kosovë, një numër të OSHC-ve dhe organizata bilaterale e multilaterale ndërkombëtare, është vendosur që PPZH 2016-2020 e UNKT-së duhet të fokusohet në tri fusha prioritare. Ajo që pason është një përshkrim më i detajuar i ndryshimeve të pritura në performancën institucionale dhe në pozitën e bartësve të të drejtave që UNKT-ja synon të arrijë në kuadër të secilës fushë prioritare, si dhe arsyetimi për përzgjedhjen e secilës nga to. Domethënë, zbrazëtitat në zhvillim dhe në të drejtat e njeriut që do të adresohen; pse UNKT-ja është e pozicionuar mirë për të punuar në mënyrë kolektive në këto fusha; dhe si janë të harmonizuara këto fusha prioritare me prioritetet ekzistuese politike dhe zhvillimore.

Fusha prioritare 1: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit

Rezultati 1.1: Sistemi dhe institucionet për Sundim të Ligjit janë të qasshme për të gjithë dhe veprojnë në një mënyrë më efikase dhe më eficiente.

Rezultati 1.2: Shoqëria civile merr pjesë në mënyrë më efikase në dizajnimin e reformave të sundimit të ligjit dhe në mbajtjen e institucioneve relevante përgjegjëse për implementimin e tyre

Autoritetet e Kosovës menaxhojnë flukset e përziera të migrameve më efektshëm dhe në harmoni me standardet

Qeverisja e mirë është një reformë thelbësore e arritur përmes zhvillimit institucional dhe njerëzor. Një nga tetë shtyllat e qeverisjes së mirë të KB-së është sigurimi i sistemit funksional për Sundim të Ligjit. Në kuadër të fushës së parë prioritare, UNKT-ja synon të punojë me partnerët e saj për të fuqizuar institucionet e Sundimit të Ligjit në mënyrë që ato të mund të përmbushin obligimin e tyre të ofrimit të qasjes në drejtësi në mënyrë më gjithëpërfshirëse, eficiente dhe efikase. UNKT-ja gjithashtu do të punojë së bashku me bartësit e të drejtave duke përkrahur dhe forcuar angazhimin e tyre në vendim-marrje dhe në mbajtjen e autoriteteve llogaridhënëse për implementimin e reformave të Sundimit të Ligjit të dizajnuara për të siguruar sistem më eficient të drejtësisë dhe qasje më gjithëpërfshirëse në të për njerëzit në mbarë Kosovën, duke përfshirë komunat veriore. Si komponentë e tretë në kuadër të kësaj fushe prioritare, UNKT-ja do forcojë konceptin e Qeverisjes së Migrimit për të siguruar që ai ndjekë standardet ndërkombëtare dhe ruan të drejtat e njeriut për migruesit dhe personat në nevojë për mbrojtje.

Fuqizimi i Sundimit të Ligjit është një nga prioritetet kryesore i palëve tjera kyçe të interesit në Kosovë. Ajo është një nga shtyllat strategjike kryesore të SKZH-së së Kosovës për pesë vitet e ardhshme; është theksuar si një nga fushat prioritare shqetësuese në Raportin e Progresit për Kosovën të KE-së 2014, ku u ngritën shqetësime serioze lidhur me pavarësinë, llogaridhënien, paanshmërinë dhe efikasitetin e gjykatësve dhe prokurorëve. Rëndësia e Sundimit të Ligjit është pasqyruar edhe në Marrëveshjen e Brukselit të 19 prillit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

UNKT-ja tashmë është partner i vendosur mirë në fushën e Qeverisjes së Mirë dhe Sundimit të Ligjit në Kosovë dhe është i pozicionuar për të kontribuar në mënyra të shumëfishta. Në pajtueshmëri me qasjen e bazuar në të drejta të njeriut mbi të cilën bazohet e gjithë puna e UNKT-së, UNKT-ja është në gjendje të sigurojë fokusin në grupet e përjashtuara nga shoqëria. Ajo gjithashtu qëndron në gatishmëri për të përkrahur integrimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare në kornizat legjislative dhe të politikave të Kosovës që lidhen me Sundimin e Ligjit dhe mund të sjellë ekspertizë për këtë fushë nga brenda apo jashtë vendit; duke përfshirë ekspertizën për fushat e drejtësisë për të mitur, anti-korrupsionin, krimin e organizuar, drejtësinë tranzicionale, DHBGJ-në, TQNJ-në dhe migrimin. Është e rëndësishme të vihet në pah pozicioni i favorshëm i UNKT-së si organ i jashtëm i pavarur që është sjellë për të ndërtuar urat dhe për të lehtësuar dialogun ndërmjet autoriteteve dhe OSHC-ve. Në këtë mënyrë, UNKT-ja sjell vite të përvojës së përbashkët në përkrahjen e qasjes në drejtësi, duke përfshirë drejtësinë për të mitur, ndihmën juridike falas dhe menaxhimin e migrimit.

Ekzistojnë disa programe të përbashkëta në progres e sipër apo të planifikuara në fushën e fuqizimit të Sundimit të Ligjit në Kosovë mbi të cilën do të ndërtohet puna e ardhshme. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar gjithashtu fuqizimit të bashkëpunimit me UNMIK-un në kuadër të kontekstit të mekanizimit të përbashkët të Pikës Globale të Kontaktit (PGK) të DPKO/UNDP për fushat e Policisë, Drejtësisë dhe Korrektuese në Sundimin e Ligjit në Situatat pas konfliktit apo situatat e krizave tjera.

40 Për shembull: Protokollin për të Parandaluar, Shuar dhe Ndëshkuar Trafikimin e Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve; Acquis e BE-së për TQNJ dhe posaçërisht Direktiva e BE-së për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave; Protokollin kundër Kontrabandës së Migruesve përmes tokës, detit dhe ajrit; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë punëtorëve emigrantë dhe anëtarëve të tyre të familjes; Parimet udhëzuese për zhvendosjet brenda vendit; Konventa e KB-së që lidhet me Statusin e Refugjatëve; Konventa e KB-së që lidhet me Statusin e Personave pa Nënshpëtim; Ecquis e BE-së për menaxhim të kufirit.

Në kuadër të kësaj fushe prioritare, UNKT-ja do të punojë me të dyja palët, bartësit e detyrave dhe bartësit e të drejtave. Në njërin anë, ndryshimi i parë i pritur është përkrahja e sistemit dhe institucioneve të Sundimit të Ligjit, e veçanërisht Ministrisë së Drejtësisë, Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial, që të bëhen më të qasshme për të gjithë dhe që të funksionojnë në një mënyrë më efikase dhe më efiçiente. Sipas kornizës së përgjithshme të standardeve kyçe ndërkombëtare të drejtave të njeriut si Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut, Deklarata e KB-së për të Drejta të Njeriut, Konventa e KB-së kundër Korrupsionit dhe Parimet Bangalore të Sjelljes gjyqësore, UNKT-ja propozon që të vazhdohet duke u bazuar në rezultatet e mëhershme në fushën e Sundimit të Ligjit për të përmirësuar edhe më tej qasjen në drejtësi, posaçërisht për gratë dhe grupet tjera të përjashtuara nga shoqëria.

Komponentët kyç të këtij plani përfshijnë përkrahjen e zgjidhjeve alternative të kontesteve, fuqizimin e Zyrave për Ndihmë Juridike dhe riorganizimin e menaxhimit të rasteve të të mbijetuarve të DHBGJ-së. UNKT-ja gjithashtu do të fokusohet në përpjekjet e saj të përbashkëta për të përkrahur harmonizimin e politikave dhe praktikave, harmonizimin e strategjive, për të targetuar zbrazëtirën në legjislacion, për të fuqizuar mekanizmat koordinues dhe për të avancuar arsimin juridik për profesionistë në fushën e Sundimit të Ligjit. Synimi kryesor është që në mënyrë të drejtëpërdrejt të stimulohet një performancë më efiçiente dhe më efikase, ndërsa tërthorazi të rritet besimi publik dhe siguria në sistemin e drejtësisë. Puna e UNKT-së do të përfshijë përpjekjet kundër korrupsionit duke angazhuar institucionet përkatëse kundër korrupsionit, platformat e OSHC-ve dhe gjyqësorin për të përmirësuar integritetin e sistemeve ekzistuese. Me iniciativat për Reformën e Administratës Publike, kapacitetet e autoriteteve do të përkrahen për të përmirësuar efiçencën e sektorit publik dhe për të riorganizuar shërbimet. Në strategjinë ekzistuese "Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017" janë katër objektiva.

E para i kushton vëmendje të veçantë fuqizimin të rolit të OSHC-ve në përpilimin dhe implementimin cilësor të ligjeve. UNKT-ja kontribuon në këtë bashkëpunim duke lehtësuar dialogun ndërmjet të gjitha palëve të interesit në nivel lokal lidhur me çështjet me interes jetik posaçërisht

për komunitetet dhe grupet e përjashtuara nga shoqëria. Kjo do të bëhet përmes konceptit të Grupeve Lokale të Veprimit si mekanizmat më efektiv ekzistues në nivel lokal në mbarë Kosovën.

Së dyti, UNKT-ja do të bëjë partneritet me OSHC-të aktive në Kosovë si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal, duke përfshirë organizatat e grave, për të fuqizuar kapacitetet e tyre për të marrë pjesë në mënyrë më efikase në dizajnimin e reformave për Sundim të Ligjit dhe në mbajtjen e autoritete relevante llogaridhënëse për implementimin e tyre. Domethënë, ndryshimi i dytë i pritur në kuadër të fushës prioritare Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit në përgjithësi synon të targetojë transparencën dhe llogaridhënie. Këto ndikojnë në besimin dhe ndjenjën e sigurisë në autoritetet për Sundim të Ligjit dhe në këtë mënyrë në qasjen në drejtësi. Roli i shoqërisë civile gjatë të dy fazave të konsultimeve Post 2015 ishte jetik për të transmetuar zërin e njerëzve të Kosovës nga të gjitha shtigjet e jetës të cilët kanë bërë të ditur se trajtimi i drejtë dhe barazia është prioriteti i tyre kryesor.

Për të përkrahur përpjekjet e autoriteteve për të trajtuar korrupsionin, UNKT-ja do të ndihmojë në promovimin e kulturës së tolerancës zero ndaj korrupsionit në sektorin publik, si dhe në masat për të zvogëluar cenueshmërinë e institucioneve qendrore e lokale, duke u bazuar në Konventën e KB-së kundër Korrupsionit. Do të inkurajohet bashkëpunimi me grupet tjera të shoqërisë, duke përfshirë sektorin privat, në hetimin dhe ndjekjen e pastrimit të parasë, kontrabandës dhe trafikimit.

Do të bëhen përpjekje për të siguruar që legjislacioni në këto fusha është konform me standardet ndërkombëtare. UNKT-ja do të përkrahë zhvillimin e kurrikullës për trajnim gjyqësor për gjykatësit dhe prokurorët. Për të kontribuar në këtë rezultat, programi i përbashkët i KB-së mund të përfshijë: zhvillimin e shkathtësive dhe shërbimeve të reja për të fuqizuar implementimin e mekanizmave dhe kornizave ligjore dhe për të drejtat e njeriut në pajtueshmëri me standardet e njohura ndërkombëtarisht; futjen e masave për përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe mbrojtjen e grupeve të përjashtuara nga shoqëria dhe rritjen e përdorimit të sistemeve të mbrojtjes nga ata drejtat e njeriut të së cilëve shkelen apo të cilët diskriminohen; krijimin e masave alternative të diversitetit dhe parandalimit për fëmijët që bien ndesh me ligjin, apo ata të cilët janë në rrezik të bien ndesh me

ligjin; përkrahjen e luftës kundër krimit të organizuar përmes menaxhimit të integruar të kufirit dhe reagimit të bashkuar në krime ndërkufitare; luftimin e migrimit të parregullt dhe TQNJ-në dhe promovimin e migrimit të rregullt; aktivitete sensibilizuese për tema të ndryshme që lidhen me Sundimin e Ligjit dhe sigurinë njerëzore.

Së treti, flukset e migrimit nga Kosova, përmes saj dhe në të kanë edhe ndikime pozitive por edhe të dëmshme në qeverisje dhe në procesin e integritimit në BE. Një organ i veçantë është themeluar në vitin 2013 në pajtueshmëri me Vendimin e Qeverisë Nr. 08/158 për të monitoruar lëvizjet e migracionit. Ky është një organ i përhershëm përgjegjës për përpilimin dhe përditësimin e profilit të migrimit, për ofrimin e rekomandimeve për zhvillim të politikave në menaxhimin e migracionit, për monitorimin e implementimit të politikave të migracionit, në veçanti të "Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018," dhe për ofrimin e ekspertizës për reformën legjislativë dhe rregullatore që lidhet me menaxhimin e migracionit. Ky subjekt i ri është një organ ndër-ministrior me mandat dhe rol të paqartë në menaxhimin e migracionit. Gjëja më e rëndësishme është se i mungon pushteti ekzekutiv. Mbetet të shihet se si do të bashkëpunojë dhe ndërveprojë me strukturat tashmë ekzistuese funksionale ekzekutive si "Koordinatori Kombëtar për Migracion" (përgjegjësi nën Zëvendësministrin eMPB-së; dhe Drejtorati për të Huaj dhe Migracion (Policia Kufitare e Kosovës), për të përmendur disa.

UNKT-ja do të punojë me institucionet kosovare në zhvillimin e kapacitetit të tyre për të menaxhuar proceset e migracionit në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, posaçërisht në fushat e TQNJ-së, kontrabandën e migruesëve, fëmijët migrues pa shoqërues, migruesit për punë, PZHBV-të dhe njerëzit në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, dhe lidhjen e tyre me politikën për popullatën e gjerë në nivelet qendrore dhe lokale. Përpjekjet janë fokusuar në ngritjen e mbledhjes së të dhënave të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe analizimin e tyre të rregullt për të zhvilluar vendim-marrje të bazuar në evidencë në të gjitha nivelet. Veçanërisht në fokus është maksimizimi i ndikimit zhvillimor të remitencave nga migruesit dhe rritja e investimeve nga Diaspora si dhe shndërrimi i pasojave negative të humbjes së kapitalit njerëzor përmes migrimit në diçka më pozitive. Këto përpjekje, përveç që nxisin zhvillimin ekonomik në Kosovë, synojnë të adresojnë faktorët kryesor shtytës të migracionit si për burrat ashtu edhe për gratë. UNKT-ja gjithashtu synon që të përkrahë fuqizimin e skemave mbështetëse të riatdhesimit për migruesit e kthyer, sistemin e menaxhimit të kufirit dhe bashkëpunimin ndërkufitar me vendet fqinje për të rregulluar flukset e migracionit, reduktuar migracionin e parregullt, për të mbrojtur kategoritë e cenueshme të migruesëve dhe për të harmonizuar atë me acquis të BE-së për menaxhim të kufirit.

Fusha prioritare 2: Gjithëpërfshirja Sociale

Rezultati 2.1: politikat dhe programet për arsim dhe punësim mundësojnë qasje më të mirë në shansa të mira punësimi për të rinjtë dhe gratë.

Rezultati 2.2: Gratë në Kosovë i gëzojnë gjithnjë e më shumë të drejtat e tyre ekonomike

Rezultati 2.3 : Politikat dhe skemat për mbrojtje sociale mundësojnë përfitime dhe qasje më të mirë në shërbime sociale për grupet më të cenueshme

Fusha e dytë prioritare – Gjithëpërfshirja sociale –fokuset në ngritjen e kapaciteteve për të rritur qasjen në mundësi të barabarta për grupet e përjashtuara nga shoqëria në Kosovë, në mënyrë që ata të bëhen me të vërtetë anëtarë aktiv të shoqërisë dhe t'i gëzojnë të drejtat e tyre në masë të plotë. Fushat e fokusimit specifik janë: qasja në

mundësi të mira punësimi dhe arsimit të cilësisë së lartë, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë; fuqizimi ekonomik i grave përtej rritjes së qasjes në punësim; dhe qasja e barabartë dhe adekuate në skemat e mbrojtjes sociale për grupet e përjashtuara nga shoqëria.

Në Kosovë, energji e bollshme politike investohet në arenën ndërkombëtare. Fushat e fokusimit janë procesi i integritetit në BE, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë dhe përpjekjet e vazhduara për të arritur njohje ndërkombëtare. Kjo agjendë politike shumë e ndjeshme nganjëherë i hedh hije nevojave për zhvillim dhe çështjeve sociale; disa nga të cilat janë theksuar në analizën e kontekstit të PPZH-së. Zbrazëtira veçanërisht shqetësuese janë gjetur në lidhje me rezultatet e tregut të punës për gratë, të rinjtë dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në fushat e arsimit dhe fuqizimit ekonomik të grave dhe në mbulueshmëri dhe cilësi të skemave të mbrojtjes sociale përtej intervenimeve në tregun e punës, veçanërisht kur bëhet fjalë për asistencën sociale.

SKZH-ja përfshinë Kapitalin Njerëzor dhe Kohezionin Social ndër katër shtyllat e saj kryesore, por me fokus të veçantë në rritjen ekonomike në vend të mirëqenies integrale të njerëzve në Kosovë. Mbrojtja sociale gjithashtu përmendet vetëm në mënyrë marginale në fushat shqetësuese në Raportin e Progresit për Kosovën të KE-së në vitin 2014. Për këtë arsye UNKT-ja e ka parë si thelbësor fokusin në këto çështje që aktualisht mund të mos konsiderohen si prioritete kryesore politike për leadershipin e sotëm, por megjithatë janë çelës për zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë të Kosovës.

UNKT-ja do të bazohet në zotimet e saja institucionale, do të përfitojë nga ekspertiza e saj teknike për të siguruar qasje të ndërtuar në të drejtat e njeriut dhe do t'i kushtojë vëmendjen e duhur barazisë në skemat e mbrojtjes sociale në Kosovë për të gjitha grupet e përjashtuara nga shoqëria, më konkretisht, për gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, të kthyerit dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Kjo fushë prioritare gjithashtu përmban tri rezultate. Dy rezultatet e para i targetojnë grupet e përjashtuara nga shoqëria dhe synojnë, ndër të tjera, rritjen e qasjes për ata në mundësi të mira punësimit dhe arsim të cilësisë së lartë. Ky rezultat është i lidhur ngushtë me rezultatet e dialogut Post 2015 në Kosovë dhe synon rritjen e llogaridhënies në emër të autoriteteve në Kosovë për përmirësimin e qasjes në mundësi të mira punësimit për të rinjtë dhe gratë (duke përfshirë ndërmarrësin dhe vetëpunësimin) dhe në arsim të mesëm për vajzat dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët.

UNKT-ja synon të punojë në të dy nivelet, atë qendror dhe atë lokal, së bashku me autoritetet, shoqërinë civile dhe drejtpërdrejt me komunitetet për të përforcuar lidhjet ndërmjet këtyre niveleve. Më konkretisht, në nivel qendror në kuadër të kornizës tashmë ekzistuese të politikave, UNKT-ja synon të kontribuojë në procese planifikimi, monitorimi dhe raportimi më të hapura dhe me më shumë pjesëmarrje, duke fuqizuar kapacitetet për detyrimin e të drejtave themelore të punës, si dhe shqyrtimin e politikave dhe përshtatjet që integrojnë opinionet nga shoqëria civile dhe nga komunitetet. Në nivelin lokal, synimi është përkrahja e zhvillimit dhe implementimit të planeve multi-sektoriale të veprimit për të implementuar strategjitë në dispozicion për punë dhe arsim, duke u fokusuar në ngritjen e potencialit lokal ekonomik dhe avancimin e ofrimit të shërbimeve për të gjitha grupet e përjashtuara nga shoqëria, me vëmendje të veçantë tek gratë dhe të rinjtë. Komunikimi dhe koordinimi ndërmjet këtyre niveleve do të integrohet në strategjitë për implementim.

Rezultati i dytë e plotëson të parin duke u fokusuar në fuqizimin ekonomik të grave; një nga grupet e popullatës me nivelin më të lartë të papunësisë dhe mos-aktivitetit dhe me vështirësitë më të mëdha në fillimin dhe mbajtjen e biznesit. Rezultati i dytë shkon përtej fuqizimit ekonomik të grave përmes politikave dhe programeve të punësimit. Aty shikohet ana e duhur e bartësit duke përkrahur më shumë gra në Kosovë që gjithnjë e më shumë të gëzojnë të drejtat e plota ekonomike, duke përfshirë trashëgiminë e barabartë, zhvillimin e biznesit dhe pjesëmarrjen në tregun e punës. UNKT-ja do të monitorojë implementimin e ligjit për trashëgimi, përmes të cilit gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta në trashëgimi. Gjithashtu do të trajtojë edhe nivelin e lartë të mos-aktivitetit tek gratë duke adresuar barrierat kyçe për pjesëmarrje më të madhe në tregun e punës, duke shqyrtuar rolet gjinore, dispozitën për pushim të lehonisë, si dhe politikën sociale që mund të ndihmojnë gratë me përgjegjësi familjare dhe përkujdes për fëmijë. Strategjitë për arritjen rezultatin e pritur përfshijnë partneritetin e fortë me OSHC-të që merren me çështjet që lidhen me gratë, si dhe programin e përbashkët të UNKT-së dhe përpjekjet e përbashkëta për advokim.

Rezultati i tretë i pritur në nivel të rezultateve në kuadër të fushës prioritare Gjithëpërfshirja

Sociale është përmirësimi i kapaciteteve të autoriteteve për të siguruar qasje të barabartë dhe të duhur në skemat gjithëpërfshirëse sociale dhe në shërbimet sociale për të gjitha grupet e përjashtuara nga shoqëria në Kosovë. Në veçanti, synimi është që të punohet drejt rritjes së nivelit të mbulueshmërisë dhe përfitimit nga asistencë sociale. Për të arritur këtë, UNKT-ja do të advokojë për një reformë të përgjithshme të Regjimit të Mbrojtjes Sociale në Kosovë. Ajo gjithashtu do të sjellë në vëmendje nevojën për të përfshirë perspektivën

e mirëqenies sociale në agjendën më të gjerë politike dhe në alokime më të larta buxhetore për asistencë sociale bazuar në kontroll të nevojave. Në nivel lokal, UNKT-ja do të punojë me autoritetet, shoqërinë civile dhe komunitetet për të zhvilluar plane të veprimit të bazuara në dëshmi për të përmirësuar performancën institucionale kur bëhet fjalë për shërbimet që u jepen grupeve më të përjashtuara nga shoqëria në Kosovë nga Qendrat për Punë Sociale në komunat e zgjedhura.

Fusha prioritare 3: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultati 3.1: Autoritetet kosovare kanë avancuar mekanizmat bazuar në dëshmi për planifikimin, implementimin dhe monitorimin e ndikimeve mjedisore në shëndet.

Rezultati 3.2: Autoritetet kosovare kanë përmirësuar mbulueshmërinë e shërbimeve themelore shëndetësore cilësore të drejta për Shëndetin Maternal, Neonatal, shëndetin e fëmijës dhe atë reproduktiv (SHMFR) dhe Sëmundjet e pa-komunikueshme (SPK).

Rezultati 3.3 Më shumë njerëz marrin sjellje që janë të shëndetshme dhe që rrisin rimëkëmbshmërinë ndaj rreziqeve potenciale nga ndotja mjedisore, fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.

Nën fushën e tretë prioritare – Mjedisi dhe shëndeti – UNKT-ja do të mbështetet në punën e saj të mëhershme për të vazhduar trajtimin e përcaktuesve social të shëndetit në Kosovë, duke përfshirë disa nga kushtet më të këqija mjedisore në Evropë. Sipas kornizës së politikave Shëndeti 2020 dhe strategjisë në përgjithësi dhe strategjive përkatëse sektoriale në Kosovë në veçanti, UNKT-ja do të punojë me autoritetet në Kosovë për të fuqizuar kapacitetet e tyre institucionale për planifikim të bazuar në evidencë, implementim dhe monitorim të ndikimit mjedisor në shëndet, si dhe për të përmirësuar mbulueshmërinë e shërbimeve cilësore dhe të drejta në fushën e SRH-së dhe NCD-së. UNKT-ja më tej pret të adresojë disa sfida që lidhen me sjelljet e që ndikojnë në shëndetin e popullatës në Kosovë, si dhe rimëkëmbshmërinë e tyre nga rreziqet potenciale nga ndotja e mjedisit, fatkeqësitë dhe ndryshimi klimatik.

Ashpërsia e kushteve mjedisore në Kosovë dhe lidhja e tyre me mirëqenien e popullatës së saj, si dhe me mundësitë e jetesës, është shumë shqetë-

suese për UNKT-në. Kështu, UNKT-ja u pajtua që të vejë theks të madh në këtë fushë prioritare duke pasur parasysh komplementaritetin e saj me SKZH-në dhe procesin e integritit evropian; si dhe duke pasur parasysh harmonizimin me Shëndeti 2020; kornizën e politikave dhe strategjinë për rajonin Evropian të OBSH-së.

Ndryshimi Mjedisor dhe Klimatik, si dhe shëndeti, për një kohë të gjatë janë konsideruar si çështje globale në të cilat KB-ja luajnë rol të rëndësishëm. Edhe pse këto tema nuk janë përfshirë në mënyrë eksplicite ndër prioritetet kryesore për lider-shipin në Kosovë, UNKT-ja e pranon që ato janë në radar të secilës palë kyçe të interesit në këtë territor. Duke u bazuar në mandatet e saj globale, me qasje në ekspertizë teknike, UNKT-ja është e pozicionuar mirë për të punuar me partnerët e saj në monitorimin dhe vlerësimin e kushteve mjedisore dhe pasojat e tyre në mirëqenien e personave që jetojnë në territorin e Kosovës, si dhe për të fuqizuar kapacitetet e autoriteteve në

41 Raportet e shqyrtimit vjetor do të përshkruajnë përfundimet dhe rezultatet faktike të aktiviteteve kryesore të shfaqura krahas atyre të specifikuar në plane të punës, si dhe kontributin e tyre për arritjen e përfundimeve të PPZH-së. Gjatë shqyrtimeve vjetore, UeA-të do të marrin vendime nëse ka nevojë të rishikohet strategjia PPZH, rezultatet apo indikatorët

Kosovë. UNKT-ja gjithashtu ka përvojë dhe ekspertizë të mirë në vend në Ballkanin Perëndimor dhe në Kosovë përmes implementimit të një numri të projekteve në fushën e Mjedisit dhe Mjedisit e Shëndetit që nga viti 1999.

Meqenëse disa nga nivelet e morbiditetit dhe vdekshmërisë vlerësohet se janë të lidhura drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me kushtet mjedisore në Kosovë, UNKT-ja do të punojë në nivel të politikave për të promovuar qasje multi-sektoriale për sfidat e ardhshme dhe do të advokojë për një pronësi më të fortë të Agjencisë së Shëndetit Mjedisor në nivelet qendrore dhe lokale. Për këtë qëllim dhe në pajtueshmëri me përfundimet e raportit për dialogun Post 2015, UNKT-ja do të fuqizojë OSHC-të që të ngritin shqetësimet e tyre dhe që të përfaqësojnë komunitetet lokale pranë autoriteteve. Më konkretisht, ndryshimi i prituri në kuadër të kësaj fushe të tretë prioritarë është realizimi i mekanizmave të avancuar për planifikim të bazuar në evidencë, implementim dhe monitorim të ndikimit mjedisor në shëndet. UNKT-ja do të ofrojë asistencë teknike për autoritetet dhe brenda Sistemit Informativ Shëndetësor për t'u siguruar se këta mekanizma janë në harmoni me standardet ndërkombëtare. UNKT-ja, për më tepër, do të ofrojë ngritje kapacitetesh për autoritetet duke përkrahur ushtrimet e tyre të para të raportimit dhe hulumtimit për vlerësimin e ndikimit të kushteve mjedisore në çështjet e caktuara shëndetësore.

Rezultati i dytë i prituri në kuadër të kësaj fushe prioritarë është promovimi i ndryshimit në aspektin e performancës institucionale të autoriteteve shëndetësore në lidhje me mbulueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve thelbësore të drejta në fushën e SRH-së dhe SJK-ve. UNKT-ja do të mbështesë Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet tjera përkatëse në ngritjen e kapaciteteve për siguri të cilësisë, identifikimin e barrierave për paanshmëri, dhe trajnimin e ofruesve të shërbimeve shëndetësore. UNKT-ja gjithashtu do të advokojë për rritjen e përfshirjes së grupeve të përjashtuara nga shoqëria në sistemin e sigurimit shëndetësor.

Në pajtueshmëri me synimin e përgjithshëm të trajtimit të përcaktuesve social të shëndetit në Kosovë, ndryshimi i tretë i prituri në fushën prioritarë Mjedisi dhe Shëndeti, lidhet me ndryshimin e sjelljes (promovimin e stilit më të shëndetshëm të jetesës) dhe të drejtat përSHSR, dhe rritjen e vetëdijes në nivel lokal për rreziqet potenciale nga ndotja mjedisore, fatkeqësitë dhe ndryshimi klimatik bazuar në raportet për rrezikun mjedisor të UN Habitat. Në kuadër të një kornize më të gjerë të ZRRF-së dhe sipas udhëzimit nga Korniza Sendai për ZRRF 2015-2030, UNKT-ja në partneritet me OSHC-të lokale, do të zhvillojë programe edukative të bazuara në komunitet, si dhe të bazuara në shkolla, për rritjen e rimëkëmbshmërisë nga këto rreziqe potenciale.

4. Implementimi i PPZH-së

4.1 Strukturat implementuese dhe mbikëqyrëse të PPZH-së

Strukturat implementuese dhe mbikëqyrëse të PPZH 2016-2020 të UNKT-së bazohen në plat-



format ekzistuese për koordinim dhe bashkëpunim të sistemit të KB-së në Kosovë tani.

UNKT-ja bashkon të gjitha Agjencitë, Fondet dhe Programet e KB-së të pranishme në Kosovë dhe koordinohet nën patronazhin e UNDC-së. UNKT-ja në nivel të Udhëheqësve të Agjencive (UeA) do të ofrojë udhëzim strategjik, koordinim të përgjithshëm dhe mbikëqyrje të implementimit të PPZH 2016-2020 të UNKT-së. Ata do të angazhohen në një proces shqyrtimi vjetor të progresit të implementimit të PPZH-së në konsultim të ngushtë me homologët në nivel të lartë. Ky shqyrtim do të adresojë statusin e përgjithshëm të implementimit, duke përfshirë ndryshime në nivel të rezultateve dhe nivel të përfundimeve. UeA-të gjithashtu do të promovojnë harmonizimin me

inicativat individuale të agjencive dhe prioritetet e politikave. Takimet shtesë periodike me autoritetet, shoqërinë civile dhe palët tjera të interesit nga komuniteti ndërkombëtar do të mbahen sipas nevojës për të promovuar harmonizimin me prioritetet zhvillimore kosovare dhe për të përkrahur koordinimin e udhëhequr nga Kosova të aktiviteteve zhvillimore.

Në nivel operativ, struktura implementuese do të ndjekë elementet dalluese të tri fushave prioritare: (1) Qeverisja dhe Sundimi i Ligjit; (2) Gjithpërfshirja Sociale; dhe (3) Mjedisi dhe Shëndeti. Tri Grupe për Prioritete të PPZH-së, të kryesuar dhe bashkë-kryesuar nga UeA-të dhe me pjesëmarrje të personelit të UNKT-së në nivel teknik do të themelohen për të implementuar iniciativat strategjike sipas secilës fushë prioritare. Këto Grupe për Prioritete do të bashkojnë anëtarët e UNKT-së me angazhimin më të madh në secilën fushë përkatëse dhe ata do të jenë përgjegjës për planifikim, implementim dhe monitorim të iniciativave strategjike nën secilën fushë prioritare. Për më tepër ata do të jenë përgjegjës për mobilizimin e përbashkët të resurseve dhe koordinimin me partnerët e jashtëm: autoritetet në Kosovë, shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar. Sipas parimeve të përgjithshme të promovimit të pronësisë vendore dhe qëndrueshmërisë, secili Grup për Prioritet do të diskutojë dhe do të vendosë për strategjitë e implementimit; kryesisht përmes programit të përbashkët dhe advokimit të përbashkët, për secilën iniciativë strategjike në kuadër të fushave përkatëse. Strategjitë e implementimit do të bazohen në mësimet e nxjerra dhe nga iniciativat e përbashkëta në progres nga PPZH-ja e ciklit 2011-2015.

Grupet për Prioritete do të takohen së paku tre herë në vit, apo sipas nevojës, për të mbikëqyrur progresin në lidhje me rezultatet e gjeneruara nga iniciativat strategjike në kuadër të fushës së tyre përkatëse prioritare. Takimi i parë i vitit do të fokusohet në shqyrtimin dhe aprovimin e iniciativave strategjike dhe planeve të punës. Shqyrtimet e mesit të vitit do të fokusohen në vlerësimin e progresit, identifikimin e fyteve të ngushta eventuale dhe vendosjen për zgjidhjet e mundshme. Në shqyrtimet e fundvitit do të kon-

trollohen arritjet në nivel të rezultateve dhe do të monitorohet progresi drejt arritjes së përfundimeve të PPZH-së.

Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Operimeve (EMO) do të ofrojnë përkrahje për harmonizimin e operimeve biznesore të nevojshme për të dhënë rezultatet e Grupeve për Prioritete të PPZH-së. Kapacitetet ekzistuese të EMO-s do të përdoren për udhëzimin e përgatitjes së elementeve BOS të cilat janë vendosur dhe ndjekur nga aktivitetet prototip të organizuara nga UNDC-ja. Të përkrahur nga UeA-të ata do të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për programe/projekte/aktivitete më efikente në kosto, më efektive dhe me cilësi më të lartë dhe do të promovojnë këto përmes advokimit dhe përmes ekipeve për komunikim.

Përveç kësaj, UNKT-ja do të vazhdojë pjesëmarrjen e saj aktive në grupe tematike të ndërthurura e më të gjera që përkrahin koordinimin nëpër OSHC-të dhe komunitetin ndërkombëtar: Grupi i Sigurisë dhe Gjinator, i përkrahur nga UNWomen; dhe Grupi Kontaktues për të Drejta të Njeriut, i përkrahur nga UNMIK-u. Përveç kësaj, UNMIK-u do të vazhdojë të kontribuojë me resurset e veta në implementimin e mandatit të vet, disa nga të cilat përkrahin me fushat prioritare të UNKT-së.

PPZH-ja do të drejtohet me plane dy –vjeçare për secilën Fushë Prioritare të PPZH-së të përgatitur nga Grupi përkatës për Prioritete, në konsultim me palët e interesit në të gjitha nivelet. Ky plan do të përfshijë rezultatet që duhen arritur, indikatorët, aktivitetet e planifikuara, buxhetet dhe partnerët përgjegjës. Këto grupe, të udhëhequra nga UeA-të dhe partnerët e jashtëm, do të përgatisë, përcjellë dhe përditësojë planet e punës, dhe do të raportojë lidhur me progresin krahas aktiviteteve të planifikuara dhe rezultateve, do të identifikojë mësimet e nxjerra, praktikat e mira dhe përshtatjet e nevojshme të rezultateve të përgjithshme, strategjive dhe alokimeve të resurseve. Kryesuesi i secilës fushë prioritare do të përmbushë funksionin e koordinimit dhe udhëheqjes në emër të UNKT-së. Zyra e UNDC-së merr pjesë në takime të Grupit për Prioritete dhe përkrahë pjesëmarrjen dhe angazhimin e agjencive jorezidente dhe atyre me bazë në rajon.

42 Siç është përmendur në Seksionin 4.1, Grupet për Prioritete do të takohen së paku tre herë në vit për të shqyrtuar progresin e implementimit dhe kufizimet krahas rezultateve të planifikuara dhe do të identifikojnë çështjet kyçe për ngritje në nivel UeA-ve. Për shifra të sakta, ju lutem referohuni tek Korniza e Rezultateve në Shtojcën 1.

Të gjitha rezultatet do të promovohen përmes fushatave të advokimit ku përfshihen mediet dhe mjetet tjera për advokim social. Platformat interaktive do të përdoren për shkëmbimin e informatave dhe njohurive për të gjitha arritjet që kanë ndikim dhe që sjellin ndryshime në indikatorët e zhvillimit dhe në realizimin e standardeve të drejtave të njeriut.

4.2 Monitorimi dhe vlerësimi

Plani i Monitorimit dhe Vlerësimit (MeV), bazuar në standardet dhe praktikën e KB-së dhe duke u bazuar në Matricën e Rezultateve në Shtojcën 1 dhe në planet përkatëse të punës për secilën fushë prioritare, do të zhvillohet si vegël kyçe për të monitoruar dhe vlerësuar progresin e bërë në implementimin e PPZH 2016-2020 të UNKT-së. Të drejtat Gjinore dhe Njerëzore do të përfshihen gjithashtu në planin e MeV-së si dhe monitorimi i ndikimeve të paqëndrueshme në grupet e synuara dhe ato të pasynuara. Qëllimi kryesor i planin të MeV-së është që t'i shërbejë si vegël menaxhimi për UeA të UNKT-së dhe Grupin për Prioritete dhe për të lehtësuar llogaridhënien interne brenda sistemit të KB-së dhe llogaridhënien e jashtme për autoritetet, shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar në Kosovë. Plani i MeV-së do të detajojë audiencën e synuar dhe përdorimin e informatave që do të gjenerohen nga sistemi i MeV-së. Ai gjithashtu do të specifikojë mjetet për grumbullimin e të dhënave dhe kriteret në nivel të rezultateve dhe përfundimeve, burimet dhe rrjedhën e informatave (shih Figurën 3 më poshtë) dhe mjetet e raportimit e periodat e raportimit.

Në nivel të rezultatit, grupet për prioritete do të mbështeteshin në informatat e ofruara në raporte lidhur me implementimin e secilës iniciativë strategjike, ndërsa në nivel të përfundimit, grupet për prioritete do të koordinonin grumbullimin e të dhënave me autoritetet përkatëse dhe me burimet tjera të të dhënave siç është përcaktuar në Matricën e Rezultateve.

Plani i MeV-së gjithashtu do të përfshijë detaje shtesë lidhur me procesin e vlerësimit të PPZH 2016-2020 të UNKT-së. Përgjithësisht, kah fundi i periudhës së implementimit do të bëhet përpilimi i një raporti të jashtëm për rëndësinë, efikasitetin, efikasitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e PPZH 2016-2020 të UNKT-së.

Kur bëhet fjalë për specifikat e raportimit, plani i MeV-së do të përmendë lidhjet me kërkesat tjera të KB-së për raportim. Për shembull, Korniza e Rezultateve të PPZH 2016-2020 të UNKT-së nuk përfshinë indikatorët për monitorimin e arritjes së draft OZHQ-ve, por përfshinë referencat për OZHQ-të përkatëse për secilën fushë prioritare. Plani i MeV-së gjithashtu do të ketë lidhjen me raportin vjetor të UNDC-së.

Plani i MeV-së gjithashtu ka lidhjet me strategjinë e komunikimit, e cila do të zhvillohet për të inkurajuar sinergjinë komunikuese për çështjet me shqetësim të përbashkët të identifikuar në PPZH 2016-2020 të UNKT-së. Ai gjithashtu do të ofrojë njohuri për ndarjen e arritjeve të indikatorëve zhvillimorë dhe standardeve të drejtave të njeriut. Plani i komunikimit do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përdorimit të teknologjive të reja informative dhe medieve sociale dhe sigurimit që zëri i grupeve të përjashtuara nga shoqëria në Kosovë të dëgjohet. Plani i komunikimit do të zhvillohet dhe implementohet në koordinim të ngushtë me ekspertët për komunikim të UNKT-së dhe pikat e kontaktit.

4.3 Plani i financimit

Të besuarit në rëndësi strategjike të iniciativave të përfshira në PPZH 2016-2020 të UNKT-së, UNKT-ja është e përkushtuar për dedikimin e resurseve të brendshme njerëzore dhe financiare drejt implementimit të saj. Kostoja indikative për arritjen e rezultateve të pritura është vlerësuar të jetë rreth 33,335,000 \$. Shpërndarja e resurseve sipas tri fushave prioritare është si në vijim:

Fusha prioritare 1:

Qeverisja dhe Sundimi i Ligjit: 15,585,000\$(47%)

Fusha prioritare 2:

Gjithëpërfshirja sociale: 11,100,000\$(33%)

Fusha prioritare 3:

Mjedisi dhe shëndeti: 6,650,000\$(20%)

UNKT-ja tashmë ka alokuar, me përkrahjen e partnerëve të saj, afërsisht 17,790,000 \$ për implementimin e iniciativave strategjike të përfshira në PPZH, duke lënë mangësi indikative prej rreth 15,545,000 \$. UNKT-ja do të kërkojë të nxisë financimin përmes përpjekjeve të koordinuara për mobilizim të resurseve brenda dhe jashtë Kosovës.

4.4 Advokimi për komunikimin e rezultateve të PPZH-së

Komunikimet e brendshme dhe të jashtme strategjike në bazën e përcaktuar në PPZH-në e UNKT-së do të sigurojnë që personeli i UNKT-së, partnerët dhe publiku i synuar të jenë të informuar lidhur me sfidat në zhvillim dhe prioritetet në Kosovë në të cilat UNKT-ja është duke punuar dhe duke vepruar si një. Komunikimet e brendshme do të ndihmojnë në krijimin e përkushtimit të personelit të KB-së lidhur me rezultatet dhe strategjitë e pritura të PPZH-së së KB-së.

Fokusimi do të jetë në vënien e theksit në nevojat shtytëse dhe sfidat për zhvillim në Kosovë si dhe në sensibilizimin për obligimet lokale dhe ndërkombëtare të Kosovës. Duke përfituar nga kryerja e dy fazave të konsultimeve Post 2015 në Kosovë që nga viti 2013, fokusi i përpjekjeve të përgjithshme të advokimit do të jetë në rritjen e mundësive për skema më të mira të mbrojtjes sociale dhe për llogaridhënie më të madhe nga institucionet kosovare. Mesazhi global që lidhet me promovimin e objektivave zhvillimore të ardhshme do të integrohet nëpër Rezultatet e PPZH-së.

Grupi Komunikues i UNKT-së përbehet nga Ekspertë Komunikimi/Pika Kontaktuese nga Agjencitë e KB-së, i kryesuar nga ekipi DCO i KB-së i drejtuar nga DC-ja dhe Udhëheqësit e Agjencive të KB-së. Ky grup do të ofrojë të gjithë përkrahjen e nevojshme për advokim për UNKT-në për aktivi-

tetet e planifikuara të grupit dhe rezultatet. Kjo do të kërkojë krijimin e hapësirës publike për debate për politika dhe arritje të konsensusit për çështjet prioritare ekzistuese dhe ato që paraqiten në të cilat do të punojë UNKT-ja.

Përfshirja e UNKT-së në punën e Grupeve për Rezultate dhe takime dhe ngjarje tjera domethënëse i mundëson asaj kuptimin e plotë të rezultateve dhe strategjive të PPZH-së së KB-së dhe që të ofrojë përkrahje të mirinformuar në komunikim me partnerët lokal, UNKT-në dhe personelin e Agjencive të KB-së. Grupet për Rezultate bëjnë lajmërimet e nevojshme lidhur me pikat e referimit të rezultateve dhe i ofron grupit materialet dhe informatat për të komunikuar rolin e sistemit të KB-së dhe mënyrën se si është duke kontribuar në arritjen e përfundimeve të PPZH-së.

Grupi i Komunikimit i KB-së gjithashtu do të ndihmojë anëtarët e UNKT-së që të përcjellin mesazhet e përbashkëta të advokimit në forma të ndryshme duke përdorur mjete të ndryshme dhe të avancuara të advokimit. Grupi do të përgatisë dhe implementojë Strategjinë më të Detajuar të Komunikimit të KB-së apo planin e detajuar të Veprimit që do të përshtatet konkretisht për komunikimin dhe advokimin e përbashkët të UNKT-së. Resurset për aktivitetet e përbashkëta të komunikimit do të ofrohen përmes modalitetit të ndarjes së kostos dhe si përpjekje të përbashkëta për mobilizim të resurseve.

Referencat

Banka Qendrore e Kosovës:Raporti Vjetor për2013;qershor2014

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik:Raporti për Gjendjen Epidemiologjike për HIV/AIDS/STInë Kosovë për vitin 2014, Prishtinë janar2015

ASK:Studimi Demografik, Social dhe i Shëndetit Reproductiv (DHS)në Kosovë; nën.2009

ASK:Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë; 2011

ASK:Migracioni Kosovar; prill 2014

ASK:Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011

ASK:Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë(MICS)2013-2014;Oct. 2014

ASK:Komunitetet RomAshkalidheEgjiptiannë Kosovë:Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS)2013-2014;tet.2014

ASK/BB:Varfëria në republikën e Kosovës në vitin 2011;mars2013.

ASK/BB/UNDP:Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë 2013;korrik 2014.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT):Indikatorët e Arsimit në Kosovë, 2009/10,2010/11dhe2011/12; qershor2013

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit (KEPA): Raport mbi gjendjen e mjedisit 2011-2012;2013

Ministria e Shëndetësisë:Raporti për Gjendjen Perinatale në Kosovë2013,Prishtinë,maj2014

Zyra e Kryeministrit /AGA:Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore dhe lokale dhe në partitë politike në Kosovë;tet.2014

OrgutConsultingAB:Profili Gjinor i Vendit:analizë e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë; prill2014

UNICEF:Studimi i nivelit bazë për dhunën në familje dhe dhunën e bazuar në gjini ;2013

UNICEF:Dëmi i qetë –raport për vlerësimin e gjendjes së shëndetit të fëmijëve të riatdhesuar;mars 2012

Shkolla për Biznesi, Ekonomi dhe Drejtësi: Analiza e Mjedisit dhe Klimës në Kosovë;mars2008

UNODC:Korrupsioni në Kosovë:Mitosja siç është provuar nga popullsia;2011

UNODC/ASK:Biznesi, korrupsioni dhe krimi në Kosovë –ndikimi i mitosjes dhe krimeve tjera në ndër-marrjet private; 2013

Banka Botërore:Analiza Mjedisore e Vendit – Kosova; janar2013

Banka Botërore:Profili i vendit – Kosova 2013; Vargu i anketimit të ndërmarrjeve

Shtojca 1: Matrica e rezultateve të PPZH-së së KB-së 2016-2020

Fusha prioritare 1: Gëverisja dhe sundimi i ligjit

OZHQ - të relevante: Objektiva 1. Dhënia fund varfërisë kudo; Objektiva 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave; Objektiva 10. Zvogëlimi i pabarazive brenda shtetit dhe ndërmjet shteteve; Objektiva 16. Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve efikase, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.


Rezultatet	Indikatorët, Niveli bazë, Synimi	Mënyrat për verifikim	Rreziqet dhe supozimet	Gjithsej resurse indikative	Resurset në dis - pozicion	Hendeku indikativ
<p><i>Rezultati 1.1: Sistemi dhe institucionet për Sundim të Ligjit janë të qasshme për të gjithë dhe veprjnë në një mënyrë më efikase dhe më eficiente.</i></p> <p><i>Agjencitë pjesëmarrëse të KB-së: UNDP, UNICEF, UNODC, UNWOMEN, UNFPA</i></p>	<p>1.1.1. Indikator: Numri i njerëzve që marrin asistencë ligjore falas të ndarë sipas gjinisë dhe popullatës jo - shumicë</p> <p>Niveli bazë: 2900 pranojnë ndihmë juridike (30% gra/30% minoritete) (2014)</p> <p>Synimi: 3500 pranojnë (45% gra / 40% minoritete) deri në vitin 2020</p>	<p>Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Raporti vjetor; (UNDP)</p>	<p>Supozimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Agjencia për ndihmë juri-dike falas do të rrisë kapacitetet për ofrimin e shërbi-meve për qytetarët. - Autoritetet mbesin të përkushtuara për implementimin e Strategjisë Kosovare për Gjyqësorin. <p>Rreziqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Agjencia për ndihmë juri-dike falas nuk garanton qëndrueshmëri të të gjitha zyrave. - Mungesa e vendimeve gjyqësore në kohë, procedime të zgjatura gjyqësore dhe grumbullimi aktual i lëndëve do të pengojnë qasjen sub-stanciale në drejtësi. 	\$2,100,000	\$1,235,000	\$865,000
<p>1.1.2. Indikator: Eficienca e gjykatave themelore: rastet e zgjidhura / rastet e reja të sjella</p> <p>Niveli bazë: 84% (2013)</p> <p>Synimi: 94% deri në vitin 2020</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor (UNDP)</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor (UNDP)</p>				

44 Agjencitë e KB-së që janë specifikuar në Mënyrat për verifikim janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, matjen dhe ndërlidhjen me agjencitë tjera të KB-së për progresin e indikatorëve (duke përfshirë Nivelet bazë dhe synimet).

45 Anketimi kërkon respondentë që janë ekspert me njohuri të specializuara lidhur me zbatimin e ligjit, gjykatat, prokurinë, mbrojtjen penale, korrigjimet, drejtësinë për të mitur apo të drejtat e njeriut në kontekstin në fjalë. Përfuturit gjithashtu do të përfshihen në anketim. Më shumë informata lidhur me Anketimin nga ekspertët mund të gjenden në raportin për Indikatorët për Sundimin e Ligjit të Kombeve të Bashkuara. context. Beneficiaries will be also included in the survey. More information about the Expert Survey can be found in the report on The United Nations Rule of Law Indicators.

1.1.3 Indikator: % e fëmijëve që kalojnë më shumë se 6 muaj në para-gjykim / paraburgimi para gjyqimit. Niveli bazë: 8% (2014) Synimi: 0% deri në vitin 2020	Shqyrtimi i brendshëm i Raporteve vjetore nga Shërbimi Korrektues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; (UNICEF)					
1.1.4 Indikator: Rezultati mesatar i ekspertëve për vlerësimin e politikës kompetente për reagim ndaj paraqitjes së rasteve të dhunës në familje paraqitjes së rasteve të dhunës në familje Niveli bazë: Deri në korrik (2015) Synimi: Deri në korrik (2020)	Anketimi nga ekspertët (UNWOMEN)					
1.1.5 Indikator: Numri i mekanizmave funksional referues të cilët ofrojnë shërbime dhe përkrahje për të mbijetuarit e dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin Niveli bazë: 0 funksionale (2014) Synimi: 3 mekanizma referues funksional deri në vitin 2019	Raportet e MPMS-së Raportet për implementimin e Planit të Veprimit të RKSKB 1325 për Kosovën (UNWOMEN)					
1.1.6 Indikator: % e të rriturve që kanë ekspozim të drejtpërdrejt apo të tërthortë ndaj përvojës së mitosjes me zyrtarë publik Niveli bazë: 9.4% (2012) Synimi: 6.4% deri në vitin 2020	Shqyrtimi diagnostiko për UNCAC Raportet Tematike (UNODC)					

46 Rezultati mesatar i ekspertëve relevant në shkallën prej 4 pikësh që i korrespondojnë katër kategorive të përgjigjes: (4) pajtohem plotësisht; (3) pajtohem pjesërisht; (2) nuk pajtohem; (1) nuk pajtohem aspak në pyetjen se "Deri në ç'shikallë pajtoheni që policia reagojnë në mënyrë kompetente dhe në pajtueshmëri me procedurat e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës në familje (dhuna që paraqitet në familje)?" Më shumë informata mund të gjenden në raportin Indikatorët e Sundimit të Ligjit të Kombeve të Bashkuara

<p>Rezultati 1.2: Shoqëria civile me rrjetë në mënyrë më efektive në dizajnimin e reformave të sundimit të ligjit dhe në mbajtjen e institucioneve relevante përgjegjëse për implementimin e tyre</p> <p>Agjencitë pjesëmarrëse të KB-së: UNDP/UNWOMEN, UNICEF</p> 	<p>1.2.1 Indikator: Niveli i kënaqshmërisë i OSHC-ve me angazhimin në dizajnimin e reformave për sundim të ligjit Niveli bazë: Të vendoset deri në prill (2016) Synimi: Të vendoset deri në (2016)</p> <p>1.2.2 Indikator: Numri i raporteve të monitorimit të performancës të përpiluara dhe të shpërndara nga OSHC - të lidhur me institucionet për sundim të ligjit Niveli bazë: 2 Synimi: 4 deri në vitin 2020</p>	<p>Studimi i ekspertëve (UNDP)</p> <p>Shqyrtimi i brendshëm i raporteve/ Monitorimi/Raportet e Progresit (UNDP)</p>	<p>Supozimet: - Nuk ka rritje të konsiderueshme në përkrahjen për avancim të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile</p>	<p>\$200,000</p>	<p>\$0</p>	<p>\$200,000</p>
--	--	---	---	------------------	------------	------------------

47 Siç janë Konventa e KB-së në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe në lidhje me Statusin e personave pa statusin të nënshpëtësishë; Parimet drejtuese për zhvendosjet brenda vendit; Protokolli kundër kontrabandës me migrues në tokë, det dhe ajër; Acquis e BE-së për menaxhim të kufirit etj.




<p>Rezultati 1.3: Autoritetet e Kosovës menaxhojnë flukset e përziera të migrimeve më efektshëm në harmoni me standardet ndërkombëtare</p> <p>Agjencitë pjesëmarrëse të KB - së: IOM, UNFPA, UNHCR, UNICEF, UNOPS, UN - Habitat</p>	<p>1.3.1 Indikator: Numri i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal që aplikojnë treguesit nga të dhënat për popullsinë dhe profilin e migrimit në vendim - marrjet e tyre për politika.</p> <p>Niveli bazë: 6 Gendrore / O Komunal (2014)</p> <p>Synimi: 9 Gendrore (MCR, MPB, MD, MPMS, MEI, MFA, MASHIT, MGLA dhe</p>	<p>Monitorimi i brendshëm/Raportet e progresit (IOM)</p> <p>»</p>	<p>Supozimet: - Harmonizimi me Acquis të BE - së vazhdon</p> <p>Rreziku: - Rritje e shpejtë në flukset e migrimit</p>	<p>\$13,285,140</p>	<p>\$11,551,020</p>	<p>\$1,734,112</p>
<p>1.3.2 Indikator: % e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të referuara tek mekanizmat adekuat mbrojtës të ndarë sipas gjinisë</p> <p>Niveli bazë: 70% (2014)</p> <p>(nga të cilët 70% burra; 30% gra)</p> <p>Synimi: 90%</p> <p>(nga të cilët 50% burra; 50% gra) deri në vitin 2020</p>	<p>Monitorimi i brendshëm/Raportet e progresit (UNHCR)</p>					
<p>1.3.3 Indikator: % e familjeve të riatdhësuar në Kosovë që janë përfitues të skemës për përkrahje për të riatdhësuarit</p> <p>Niveli bazë: 70% (2014)</p> <p>Synimi: 90% deri në vitin 2020</p>	<p>Baza e të dhënave e familjeve të riatdhësuar MPB, dhe raportet tremujore të OJQ - së Monitor (UNICEF)</p>					
<p>1.3.4 Indikator: Numri i objekteve funksional të infrastrukturës për menaxhimin e kufirit (IMIK)</p> <p>Niveli bazë: 2 (2014) Synimi: 8 deri në 2020</p>	<p>Monitorimi i brendshëm/Raportet e progresit (UNOPS)</p>					
<p>1.3.5 Indikator: % e vendimeve të marra lidhur me statusin e refugjatit</p> <p>Niveli bazë: 0% (2014) nga aplikimet totale</p> <p>Synimi: 10% deri në vitin 2020 (10% e të gjitha aplikimeve, meshkuj e femra)</p>	<p>Monitorimi i brendshëm/Raportet e progresit (UNHCR)</p>					
<p>Gjithsej fusha prioritare I: Geverisja dhe sundimi i ligjit</p>						



Fusha prioritare 2: Gjithëpërfshirja Sociale

Rezultatet	Indikatorët, Niveli bazë, Synimi	Mënyrat për verifikim	Rreziqet dhe supozimet	Gjithsej resurse indikative	Resurset në dispozicion	Hendeku indikativ
<p><i>Rezultati 2.1: politikat për arsim dhe punësim dhe programet mundësojnë qasje më të mirë në mundësi të mira punësimi për të rinjtë dhe gratë.</i></p> <p><i>Agjencitë pjesëmarrëse të KB-së: UNDP/UN Women, UNICEF, ILO, UNV</i></p>	<p>2.1.1 Indikator: Numri i politikave të reja dhe të rishikuara për të përkrahur mundësitë e punësimi për të rinjtë dhe gratë</p> <p>Niveli bazë: 3 politikat ekzistuese (Politika për bujqësi, Strategjia e MPMS - së 2014-2020, Strategjia për zhvillimin e NVM - ve 2012-2016 (MTI); (2014)</p> <p>Synimi: 4 Politika të zhvilluara dhe 3 Politika ekzistuese të shqyrtuara për përfshirje më të mirë të grave dhe të rinjve deri në vitin 2020</p> <p>2.1.2 Indikator: Numri i grave përfutuese nga masat e politikave për punësim nga MTI-ja, MPMS-ja dhe MBPZHR-ja</p> <p>Niveli bazë: 1.376 (30% nga të gjithë përfutuesit) (MPMS 2014)</p> <p>Synimi: Së paku 2064 deri në vitin 2020 (40% nga të gjithë përfutuesit)</p> <p>2.1.3 Indikator: Norma e kalimit të vajzave në arsimin e mesëm të lartë</p> <p>Niveli bazë: 89% (2014) Synimi: 95% deri në vitin 2020</p> <p>2.1.4 Indikator: Numri i të rinjve (15 - 24) përfutues (të ndarë sipas gjinisë) nga masat e politikave për arsim nga MTI-ja, MPMS-ja, MASHT-i dhe MBPZHR-ja</p> <p>Niveli bazë: 1.353 përfutues (29% nga të gjithë përfutuesit) (32%F) (MPMS2014)</p> <p>Synimi: Së paku 2029 përfutues (40% nga të gjithë përfutuesit) (42%F) (MPMS) deri në vitin 2020</p>	<p>Shqyrtimi i dokumenteve të politikave - Monitorimi i brendshëm/Raportet e progresit (UNDP)</p> <p>Raportet zyrtare të MPMS-së; MTI-së; MBPZHR-së (UNDP)</p> <p>(UNICEF)</p> <p>Raportet zyrtare të MPMS-së; MTI-së; MBPZHR-së, MASHT-it (UNDP)</p>	<p>Supozimet: -Institucionet mbeten të përkushuara për implementimin dhe zgjerimin e politikave për punësim</p> <p>Rreziqet: -Ndryshimi në fokus të institucioneve të Kosovës në fusha tjera prioritare</p> <p>-Rënia e rritjes ekonomike mund të ndikojë në krijim të vendeve të punës.</p>	\$8,700,000	\$2,630,000	\$6,070,000




<p>Rezultati 2.2: Gratë në Kosovë i gëzojnë çdo herë më shumë të drejtat e tyre ekonomike</p> <p><i>Agjencitë pjesëmarrëse të KB - së: UNWOMEN, UNDP, UNW</i></p>  	<p>2.2.1 Indikatorri: Niveli i mos-aktivitetit për gratë Niveli bazë: 79% (2013) Synimi: 60% deri në vitin 2020</p> <p>2.2.2 Indikatorri: Përqindja e pronave në pronësi të grave. Niveli bazë: 6% (2014) Synimi: Së paku 10% deri në vitin 2020</p>	<p>Agjencia për Statistika të Kosovës, Studimi i Fuqisë Punëtore (UNWOMEN)</p> <p>Raporti i Agjencisë Kadastrale të Kosovës Raportet për të drejtat pronësore nga GIZ (UNWOMEN)</p>	<p>Supozimet: - Vazhdimi i trendeve të rritjes së fuqizimit ekonomik të grave</p> <p>Rreziqet: - Ndryshimi në fokus të institucioneve të Kosovës në fusha tjera prioritare - Rezistenca për të ndryshuar normat sociale të ndërlidhura me gjininë - Ndikimi i rritur i ideologjisë radikale</p>	<p>\$2,000,000</p>	<p>\$260,000</p>	<p>\$1,740,000</p>
<p>Rezultati 2.3 : Social protection policies and schemes enable greater benefits and access to social services to the most vulnerable groups⁴⁹</p> <p><i>Participating UN agencies: UNICEF, UNDP, ILO</i></p> 	<p>2.3.1 Indikatorri: % e të varfërve që pranojnë asistencë sociale Niveli bazë: 23% (2009) Synimi: 40% deri në vitin 2020</p> <p>2.3.2 Indikatorri: Shuma (në€) e përfitimeve mujore me para të gatshme për skemat e asistencës sociale për familjet një anëtarëshe Niveli bazë: €40 për familjet një anëtarëshe (2014) Synimi: Së paku €63 (deri në80€) për familjet një anëtarëshe si bazë (UNDPV-lera e Vërtetë e Asistencës Sociale, 2014) deri në vitin 2020</p> <p>2.3.3 Indikatorri: Numri minimal i shërbimeve sociale që ofrohet nga Qendrat për Punë Sociale në komunat e zgjedhura Niveli bazë:3 (2014) Synimi:6deri në vitin 2020</p>	<p>ASK/Studimi Buxhetor i Familjeve (UNICEF)</p> <p>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / të dhëna administrative (UNICEF)</p> <p>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / të dhëna administrative (UNICEF)</p>	<p>Supozimet: - Institucionet mbeten të përkushtuara për implementimin dhe zgjerimin e mbrojtjes sociale</p> <p>Rreziqet: - Ndryshimi në fokus të institucioneve të Kosovës në fusha tjera prioritare - Rënia e rritjes ekonomike mund të ndikojë në mbrojtjen sociale.</p>	<p>\$400,000</p>	<p>\$100,000</p>	<p>\$300,000</p>
<p>Gjithsej fusha prioritare 2: Gjithëpërfshirja Sociale</p>						
<p>\$11,100,000</p>			<p>\$2,990,000</p>	<p>\$8,110,000</p>		

Fusha prioritare 3: Mjedisi dhe shëndeti

OZHQ-të relevante: Objektivat 3. Sigurimi i jetesës së shëndoshë dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat; Objektivat 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave; Objektivat 11. Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurt, të rimëkëmbshme dhe të qëndrueshme

Rezultatet	Indikatorët, Niveli bazë, Synimi	Mënyrat për verifikim	Rreziqet dhe supozimet	Gjithsej resurse indikative	Resurset në dispozicion	Hendeku indikativ
<p><i>Rezultati 3.1-Autoritetet kosovare kanë avancuar mekanizmat për planifikimin e bazuar në dëshmi, implementimin dhe monitorimin e ndikimeve mjedisore në shëndet.</i></p> <p><i>Agjencitë pjesëmarrëse të KB-së: WHO, UNDP, UN-Habitat, UNEP</i></p>	<p>3.1.1 Indikator: Numri i sistemeve monitoruese funksionale që monitorojnë ndikimin mjedisor në shëndet</p> <p>Niveli bazë: 0 (2014)</p> <p>Synimi: 3 sisteme monitoruese (për industrinë ndotëse, vendet industriale të kontaminuara dhe cilësinë e ajrit) janë në harmoni me standardet ndërkombëtare deri në vitin 2020</p> <p>3.1.2 Indikator: Numri i studimeve të kryera nga autoritetet kosovare për vlerësimin e ndikimit mjedisor në rezultatet e caktuara shëndetësore</p> <p>Niveli bazë: 1 studim (2014)</p> <p>Synimi: së paku 2 studime për shëndetin mjedisor dhe 2 për vlerësimin mjedisor deri në vitin 2020</p>	<p>Shqyrtim në nivel ekspertësh i raporteve/ Vlerësimi duke përdorur listë kontrolluese të bazuar në standarde ndërkombëtare (UNDP)</p> <p>Analiza e raporteve të studimeve të kryera - Monitorimi i brendshëm/Raportet e progresit (WHO)</p>	<p>Supozimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shoqëria civile në mënyrë aktive advokon dhe promovon rëndësinë e ndikimit mjedisor në shëndet. -Kosova mbetet e përkushtuar për përmirësimin e ndikimit mjedisor në shëndet. <p>Risk: Rënia e mundshme e interesimit të donatorëve për ndikimet mjedisore në shëndet.</p>	\$1,050,000	\$50,000	\$1,000,000



<p><i>Rezultati 3.2: Autoritetet kosovare kanë përmirësuar mbulueshmërinë e shërbimeve themelore shëndetësore cilësore të drejta për Shëndetin Maternal, Neonatal, shëndetin e fëmijës dhe atë reproduktiv (SHMNFR) dhe Sëmundjet e pa-komunikueshme (SPK).</i></p> <p><i>Agjencitë pjesëmarrëse të KB-së: WHO, UNFPA, UNICEF</i></p> 	<p>3.2.1 Indikator: Përqindja e shpenzimeve nga xhepi nga shpenzimet totale për shëndetësi Niveli bazë: i vlerësuar 30%-50%(2014) Synimi: Përqindja e shpenzimeve nga xhepi nën 20% nga shpenzimet totale për shëndetësi deri në vitin 2020</p> <p>3.2.2 Indikator: Përqindja e fëmijëve në moshën 12-23 muaj të imunizuar me DTP3 Niveli bazë: Kosova 95% dhe rom, ashkali dhe egjiptian 63% (2013-2014) Synimi: Kosova >95% dhe rom, ashkali dhe egjiptian 90% deri në vitin 2020</p> <p>3.2.3 Indikator: Proporcioni i grave në moshën 15-49 vjeçare me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit të cilave iu është matur presioni i gjakut dhe kanë dhënë mostrat e urinës dhe të gjakut gjatë shtatzënisë së fundit që ka çuar në lindje të gjallë Niveli bazë: 81% (2014) Synimi: së paku 90% deri në vitin 2020</p> <p>3.2.4 Indikator: Niveli i infektimit brenda spitalor në MNCRH Niveli bazë: 17.4% Niveli i infektimit brenda spitalor (2014) Synimi: 10% Niveli i infektimit brenda spitalor deri në vitin 2020</p> <p>3.2.5 Indikator: Niveli i vdekshmërisë së parakohshme nga sëmundje kardiovaskulare; Niveli bazë: 62,75% (2011) Synimi: 50% deri në vitin 2020</p>	<p>Studimi i buxhetit familjar – anketimi nga ASK/BB (WHO)</p> <p>MICS (UNICEF)</p> <p>MICS (UNFPA)</p> <p>Raporti për kontrollin e infeksioneve nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (WHO)</p> <p>Raportet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (WHO)</p>	<p>Supozimi: Ministria e shëndetësisë e përkushtuar për të vazhduar me reformimin e sektorit shëndetësor duke përfshirë futjen e fondit për sigurim shëndetësor</p> <p>Rreziku: Mungesa e financimit të mjaftueshëm për shëndetësi të gjithanshme</p> <p>Rreziku 2: Prioritetet e Kosovës nuk janë të favorshme për reformat në shëndetësi</p>	<p>\$2,800,000</p>	<p>\$950,000</p>	<p>\$1,850,000</p>
---	--	--	--	--------------------	------------------	--------------------

<p>Rezultati 3.3 Më shumë njerëz marrin sjellje që janë të shëndetshme dhe që rrisin rimëkëmbshmërinë ndaj rreziqeve potenciale nga ndotja mjedisore, fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.</p> <p><i>Agjencitë pjesëmarrëse të KB-së: WHO, UNFPA, UNICEF, UNDP, UNW, UNEP</i></p>	<p>3.3.1 Indikator: Përhapja e përdorimit të duhanit tek të rriturit në moshën 15 vjeç apo më shumë Niveli bazë: 28.4% (W:19.3%, M:34.3% (2013) Synimi: nën 25% (W:16%, M:31%) deri në 2020</p> <p>3.3.2 Indikator: Norma e përhapjes së përdorimit të kontraceptivëve modern Niveli bazë: 13.7% (2013) Synimi: 15.5% deri në vitin 2020</p> <p>3.3.3 Indikator: % e grave të reja dhe burrave të ri në moshën 15 - 24 vjeçare të cilët saktë identifikojnë mënyrat për parandalimin e transmetimit të HIV-it dhe të cilët kundërshtojnë keqperceptimet kryesore për transmetimin e HIV-it Niveli bazë: femra 17.4%, meshkuj 16.8% (2013) Synimi: femra dhe meshkuj së paku 30% deri në vitin 2020</p> <p>3.3.4 Proxy Indikator: Përqindja e publikut të cilët konsiderojnë që mjedisi është jo i shëndetshëm, të ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike Niveli bazë: 43.01% e publikut konsiderojnë që mjedisi është jo i shëndetshëm (femra: 40.78%, meshkuj: 45.90% shqiptarë, 42.30% serb, 63.81% të tjerë, 42%) Synimi: 58% e publikut konsiderojnë që mjedisi në Kosovë është jo i shëndetshëm (femra: 55%, meshkuj: 60%, shqiptarë 47%, serb 70%, të tjerë 57%) deri në vitin 2020</p> <p>3.3.5 Niveli i vetëdijes për rreziqet potenciale nga fatkeqësitë dhe përshtatja ndaj ndryshimit të klimës në lokacionet e përzgjedhura Niveli bazë: Sipas rajoneve ku përmblytet paraqiten më së shpeshti: Mitrovicë/a 49.42% të konsiderohet që ka mundësi të ndodhin. Për tërmete Peja 67.82%, Gjilan 31.2% të konsiderohet që ka mundësi të ndodhin. Synimi: Në Mitrovicë, 65% e konsiderojnë të mundshme vërshimet. Në Pejë dhe Gjilan 77% dhe 41% respektivisht e konsiderojnë të mundshëm ndodhjen e tërmeteve deri në vitin 2020</p>	<p>MICS dhe raportet e IKSHIP - së, anketat (WHO)</p> <p>MISC, DHS (UNFPA)</p> <p>MICS, DHS (UNFPA)</p> <p>Raporti i UNDP - së Pulsi Publik (UNDP)</p> <p>Raporti i UNDP - së Pulsi Publik (UNDP)</p>	<p>Supozimi: OSHC - të vazhdojnë të advokojnë për rëndësinë e sjelljeve të shëndetshme dhe rimëkëmbshmërinë ndaj rreziqeve potenciale mjedisore, fatkeqësitë dhe ndryshimi klimatik.</p> <p>Supozimi: Opinioni publik nuk shqetësohet nga zhvillimet madhore politike dhe ekonomike</p> <p>Rreziku 1: Mungesa e fondeve të mjaftueshme të alokuara nga institucionet e Kosovës për mbajtjen e fushatave gjithëpërfshirëse të sensibilizimit dhe promovimit/edukimit</p>	<p>\$2,800,000</p> <p>\$1,011,900</p> <p>\$1,788,100</p>
<p>Gjithsej fusha prioritare 3: Mjedisi dhe shëndeti</p>		<p>\$6,650,000</p> <p>\$33,335,140</p>	<p>\$2,011,900</p> <p>\$17,787,928</p>	<p>\$4,638,100</p> <p>\$15,547,212</p>
<p>GJIHSEJTI ESTIMATED CDP 2016-2020</p>				




Shtojca 2: Strategjitë sektoriale dhe planet e veprimit me rëndësi për PPZH-në

- Strategjia Kosovare kundër Korrupsionit (2004-2009);
- Plani strategjik për bashkëpunim ndër-ministror në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit (2013-2015);
- Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar (2009-2012);
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër trafikimit të drogës (2012-2017);
- Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të grumbulluara , gusht2013;
- Plani strategjik për Gjyqësorin në Kosovë2014-2019;
- Zhvillimi Strategjik i Policisë së Kosovës 2011-2015;
- Strategjia për politika për komunitet dhe Plani i Veprimit 2012- 2016;
- Strategjia për asistim në sundim të ligjit në Kosovë 2016-2019;
- Strategjia kombëtare për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës 2009-2014;
- Strategjia për integrim të fëmijëve rom, ashkalidhe egjiptian në arsim;
- Plani kombëtar dhe komunal i veprimit për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve (2007-2009);
- Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015;
- Strategjia shkollore për promovim të shëndetit 2007-2017;
- Strategjia e Kosovës për Arsim 2011-2016;
- Programi kosovar për barazi gjinore, 2008-2013;
- Plani i veprimit për implementimin e RKSKB1325,2013-2015;
- Strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, 2010-2014;
- Plani kosovar i veprimit për fuqizimin ekonomik të grave, 2011-2013;
- Strategjia mjedisore e Kosovës(KES),2011-2015;
- Plani kombëtar i veprimit për mjedisin (NEAP),2011-15;
- Strategjia kornizë për ndryshimin klimatik 2014 -24;
- Strategjia për shëndetin me planin përkatës të veprimit, 2014-2020;
- Strategjia për zhvillimin e NVM-ve(2012-2016);
- Strategjia për bujqësi dhe zhvillim rural (2007-2013);
- Strategjia sektoriale e MPMS-së (2014-2020)dhe plani i veprimit (2014-2016);
- Strategjia për Migracion dhe plani i veprimit 2013-2018;
- Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.
- Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2014-2018;
- Strategjia kombëtare për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë 2013-2017dhe plani përkatës i veprimit;dhe
- Strategjia për Diasporën dhe Migracionin 2013-2018.

Shënim 1: Kjo listë është indikative e jo e shterur.

Shënim 2: Periudha e implementimit të disa strategjive bie jashtë periudhës së implementimit të PPZH-së. Sidoqoftë, është parë e arsyeshme që të përfshihen pasi që praktika është që të vazhdohet me implementimin e tyre derisa të zhvillohet strategjia e re.

 **SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS**





UNKT



UNITED NATIONS KOSOVO TEAM

**Zajednički plan razvoja (ZPR)
2016–2020**

Tim Ujedinjenih nacija na Kosovu (TUNK) je čvrsto opredeljen da zajedno radi sa institucijama i ljudima na Kosovu kako bi identifikovali i ostvarili svoje razvojne aspiracije i ciljeve.¹ Ova snažna posvećenost je potkrepljena u vidu Zajedničkog plana razvoja Ujedinjenih nacija 2016-2020 (ZPR), koji je predstavljen u vidu petogodišnjeg programskog okvira koji opisuje zajedničke strateške prioritete TUNK-a koji će zahtevati pun opseg stručnosti i sredstava iz programa, fondova i agencija Ujedinjenih nacija.

